


Profesor Ardian Civici me librin “Udhëtim në tri kohë”, një manual për intelektualët, politikanët, diplomatët, studentët dhe qytetarët për të njohur periudhat e evoluimit të shtetit shqiptar në 70 vitet e fundit; Libri është konceptuar një “udhëtim” në tre etapa: komunizmi, tranzicioni dhe kapitalizmi shqiptar në dialog me Alda Bardhylin

ADRIAN CIVICI

Udhëtimi në tri kohë: Komunizmi, tranzicioni dhe kapitalizmi




Portreti nga Ina Lajthia

IN MEMORIAM
HANS JOACHIM LANKSCH

“NUK BËN TË VDESËSH I URITUR...”

Nga Anna Kove

(fq. 5)



Një tekst i panjohur i Mjedës mbi poezinë është botuar në revistën “Shkëndija”, e përkohshme letrare dhe artistike, viti I, nr. 8-9, shkurt-mars 1941, drejtuar nga Ernest Koliqi.

Dom Ndre Mjeda PËRMBI POEZI PËRGJITHËSISHT

(fq. 6)


TEATRI I OPERAS DHE BALETIT



VIKENA KAMENICA AZUCENA, CIGANIA TRAGJIKE E VERDIT

Sopranoja në shfaqjen “Il Trovatore”

(Fq. 12)



ENIGMA E EDWARD FITZGERALD-IT

Me rastin e 160-vjetorit të botimit të versionit të parë të “Rubajive” (Rubaiyat) të Omar Khayyami-t, të përkthyer nga Edward Fitzgerald-i

nga Jorge Luis BORGES

(Fq. 14)

Përkthimi i Cuk Simonit

SI ERDHI PËR HERË TË PARË “PINOKU” NË SHQIP

(fq. 10)

Këngë të
Solomonit

**SADIK
BEJKO**

BIBLIOTEKË



Ora e
anatomisë...

**ANISA
MARKARIAN**

Profesor Ardian Civici me librin “Udhëtim në tri kohë”, një manual për intelektualët, politikanët, diplomatët, studentët dhe qytetarët për të njohur periudhat e evoluimit të shtetit shqiptar në 70 vitet e fundit; Libri është konceptuar një “udhëtim” në tre etapa” komunizmi, tranzicioni dhe kapitalizmi shqiptar në dialog me Alda Bardhylin

ARDIAN CIVICI UDHËTIMI NË TRI KOHË: KOMUNIZMI, TRANZICIONI DHE KAPITALIZMI

Çfarë nënkuptonte në përditshmërinë e jetës suaj socializmi dhe diktatura e proletariatit? Si e kuptonit, pranonit dhe ndoshta e “justifikonit” të jetuarit në një vend që e shpallte dhe zbatonte diktaturën si “lumturinë më të madhe” dhe “sistemin politiko-shoqëror më të mirë”?

A.C: Në jetën tonë të përditshme, deri në vitin 1990, “diktatura e proletariatit” ishte shprehja që shfaqej e dëgjohej çdo ditë e kudo, në fjalimet e Enver Hoxhës, gazetatat e përditshme, në radio dhe televizion, në çdo shkollë e universitet, në parullat pa fund në çdo cep të vendit, në manifestimet e parakalimet përkujtimore, në veprat e Hoxhës dhe PPSH-së që ishin prezente në çdo familje etj. Ne ishim të “droguar” dhe të asfiksuar nga presioni i jashtëzakonshëm politik, ideologjik e mediatic i përditshëm dhe agresiv për shpëlarjen e trurit apo “edukimin e popullit” me ideologjinë marksiste-leniniste, që “qershinë mbi tortë” kishte diktaturën e proletariatit. Në çdo institucion, ndërmarrje apo fabrikë, fermë bujqësore apo kooperativë, organizatë apo shoqatë të çdo lloji, zakonisht të premteve, zhvilloheshin rregullisht “format politike”, që nënkuptonin leximin kolektiv të “veprave të xhaxhit” dhe materialeve të tjera propagandistike të Partisë. Gjithkush duhej të vinte i përgatitur me konspekte, pyetje e diskutime, gjithkush duhej të tregonte besimin, devotshmërinë dhe zellin e tij në ideologjinë marksiste-leniniste dhe “mësimet e Partisë”. Në shkollë, sidomos në gjimnaze dhe universitete, lëndët dhe provimet më të rëndësishme ishin “Historia e PPSH”, “Njohuritë dhe filozofia marksiste-leniniste” dhe “Ekonomia politike e socializmit”. Vlerësimi më i rëndësishëm për çdo njeri, kur kalonte nga një vit shkollor në tjetrin, merrte një diplomë, kur përfitonte “kategori profesionale” apo emërohej në një vend të ri pune, ishte “qëndrim i mirë ideologjik dhe shkalla e përvetësimit të historisë së PPSH-së dhe doktrinës marksiste-leniniste”.

Presioni për hyjnizimin e “diktaturës së proletariatit”, mishëruar në sistemin politiko-ekonomik e shoqëror shqiptar ishte i jashtëzakonshëm duke mos lënë hapësirë dhe shteg për asnjë lloj mendimi

apo reflektimi alternativ. Që nga vitet e gjimnazit e deri në përfundimin e ciklit të parë të kualifikimit tim shkencor pedagogjik 1974 — 1985, kam dhënë mbi 10 herë provime për lëndë dedikuar tërësisht “historisë së PPSH-së, mendimit revolucionar të shokut Enver dhe teorisë marksiste leniniste”. Ne flisnim për sistemin kapitalist, për demokracinë borgjeze perëndimore, për zgjedhjet e lira në Europë dhe SHBA etj., por informacioni real për to dhe aq më pak përmbajtja thelbësore e tyre, ishte pothuajse i pamundur të qarkullonte dhe disponohej në Shqipëri, përveç faktit se edhe thjesht shfaqja e interesit dhe diskutimi për to ishte tejet i rrezikshëm dhe si pasojë e zellit të spiunëve e denoncuesve që ishin kudo, rrezikohej të përjashtohesh nga shkolla, të dërgohesh në fshat për riedukim, të cilësohesh familje me biografi të keqe, të internohesh, të akuzohesh për agjitacion e propagandë, të internohesh, burgosesh apo dhe pushkatohesh.

Arsyetimet e Marksit dhe Engelsit se “ndërmjet

shoqërisë kapitaliste dhe shoqërisë komuniste, ekziston një periudhë tranzitore transformimesh revolucionare nga njëra te tjetra, periudhë që korrespondon me një fazë tranzicioni politik, në të cilin shteti nuk mund të jetë gjë tjetër veçse diktaturë revolucionare e proletariatit, se proletariati nuk mund të organizohet si klasë sunduese pa shkatërruar në mënyrë despotike të drejtën e pronës dhe marrëdhëniet borgjeze në prodhim”; analizat dhe qëndrimet e Leninit se “proletariati ka nevojë për zotërimin e shtetit në këtë periudhë tranzitore, se deri sa të arrihet komunizmi, proletariati duhet të ketë pushtet të plotë politik dhe të instalojë diktaturën e tij për të shkatërruar klasat shoqërore kundërshtarë, se diktatura e proletariatit nuk është gjë tjetër veçse monopoli socialist mbi shtetin”; për të ardhur te vlerësimet e Stalinit se “diktatura e proletariatit nuk mund të jetë integrale, d.m.th. demokraci për të gjithë, për të pasurit dhe për të varfrit, ajo duhet të jetë shtet demokratik, por vetëm për proletariatin, dhe shtet diktatorial vetëm kundër borgjezisë” etj., ishin të “vetmet arsyetime e vlerësime ideologjike” që bombardonin çdo ditë e në çdo drejtim formimin tonë shoqëror, shkollor, akademik apo intelektual. Përveç dogmës që pranohej 100% si e saktë shkencërisht, veçanërisht nga shpjegimet “shteruese të materializmit dialektik e historik”, përditshmëria dhe “justifikimi” i diktaturës së proletariatit në Shqipëri, e gjithë përballja jonë me të lidhej edhe me argumentet për “legjitimitetin” e saj. Ashtu si në të gjitha vendet e tjera ish-socialiste të Europës Qendrore e Lindore, edhe në Shqipëri, “legjitimiteti i socializmit dhe diktaturës së proletariatit” u asociua me shpresën e popullit të Partia Komuniste, teoria e saj marksiste-leniniste, shteti socialist dhe lidhshipi e pagabueshmëria e “udhëheqësit të shquar”.

Duke iu referuar një shprehjeje të Ismail Kadarese në romanin “Ftesë në Studio”, shqiptarët ishin i vetmi popull i Lindjes që festuan për hyrjen në diktaturë në vitin 1946. Në hotel “Dajti” u dha një ballo e madhe ku u festua solemnisht “me këngë, valle e doli” shpallja e Republikës Popullore të Shqipërisë, që bazohej në sistemin politik të diktaturës së proletariatit!

Në jetën tonë të përditshme, në të gjitha aspektet e saj, “legjitimiteti” i diktaturës së proletariatit “zgjerohej e forcohej çdo ditë, pasi çdo lloj treguesi, arritje apo suksesi ekonomik dhe social, amplifikohesh e servirej nga propaganda zyrtare, si “meritë e diktaturës së proletariatit dhe vijës rigorozë të partisë për zbatimin e pastër të saj në Shqipëri”.

Propaganda, media dhe i gjithë aparati partiak e shtetëror na përsërisnin pa fund se “Partia dhe shoku Enver përfaqësonin zërin e vetëm legjitim të klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste, kriterin e vetëm të së vërtetës ...” Kudo nënvizohej e shkruheshin parulla pa fund, se Partia kishte monopolin mbi të vërtetën, ndërkohë që “qëllimi i saj themelor ishte çlirimi i shqiptarëve dhe proletariatit botëror nga vargonjtë e borgjezisë dhe kapitalizmit shfrytëzues”. E thënë ndryshe, të gjithë ishin në një trysni të tmerrshme për të besuar dhe për t’u bindur, “me hir apo me pahir”, se Partia kishte ardhur në skenë për të realizuar një mision historik, për të cilin gëzonte të drejtën ta ushtronte pushtetin e vetme, pa e ndarë me asnjë forcë tjetër politike apo organizatë të llojeve të ndryshme. Instrumenti “magjik” që garantonte këtë rol të Partisë ishte pa dyshim “diktatura e proletariatit”.

Realiteti jonë “socialist” dëshmonte çdo ditë, se në vend që Partia të vendosej në shërbim dhe funksion të shtetit, ndodhte krejtësisht e kundërta, shteti dhe qeverisja vendoseshin në funksion të “vullnetit legjitim të Partisë”, si i vetmi



institucion që përfaqësonte legjitimitetin kombëtar dhe “autoriteti racional” e ushtronte këtë legjitimitet nëpërmjet diktaturës së proletariatit. Në simbolet kombëtare u vendosën simbole ideologjike e politike, ylli partizan, data e Kongresit të Përmetit, drapri dhe çekani, pushka dhe kazma, kallëzat e grurit etj.

Duke luftuar egërsisht fenë dhe të gjitha institucionet fetare, duke filluar nga Marksi që thoshte se “feja është opium për popullin”, vazhduar me Stalinin në kuadrin e “politikës antifetare” të viteve 1920 — 1941, dhe përfunduar me Enver Hoxhën që në vitin 1967 ndaloi dhe shkatërroi brutalisht çdo gjurmë të fesë në Shqipëri, teoria marksiste-leniniste, diktatura e proletariatit dhe socializmi e shihnin veten si një “religjion” unik e të veçantë, të papajtueshëm me çdo lloj religjioni tjetër. Katedralet, kishat, xhamitë e teqetë u prishën, çdo lloj aktiviteti fetar u ndalua dhe u shpall i ndëshkueshëm, Bibla dhe Kurani u zhdukën, priftërinjtë, hoxhallarët, peshkopët e imamët u dënuan, u persekutuan, u burgosën e u pushkatuan. Ligjet e Zotit të shprehura në 10 Urdhëresat e Testamentit të Vjetër u zëvendësuan me “10 urdhëresat e njeriut të ri socialist”: -Ti duhet të jesh solidar me gjithë punonjësit dhe proletarët e botës dhe me gjithë vendet socialiste;-Ti duhet ta duash atdheun dhe të jesh gjithmonë i gatshëm të japësh gjithçka për të mbrojtur pushtetin e punëtorëve dhe fshatarëve; - Ti duhet të ndihmosh fuqimisht në eliminimin e shfrytëzimit të njeriut nga njeriu; - Ti duhet të bësh gjithçka për socializmin, sepse socializmi çon drejt një jete më të mirë gjithë proletarët;

A ishte ekonomia ajo që diktoi rrëzimin e diktaturës në Shqipëri, duke pasur parasysh krizën apo recensionin e gjatë pas ndërprerjes së ndihmave nga aleatët e Lindjes, që e detyruan shtetin shqiptar të fillonte raportet me vende të Europës Perëndimore gjatë 1985 — 1990?

A.C:Mendoj se krizat ekonomike e financiare, të dukshme e të fshehura, dhe rezultatet mediokre të ekonomisë socialiste në Shqipëri, ishin faktor themelor i rrëzimit të diktaturës, i zhvleftësimit total të saj në sytë e shqiptarëve. Që në vitin 1945, në kuadrin e besimit se ekonomia socialiste do t’ia ndryshonte njëherë e përgjithmonë “situatën ekonomike dhe nivelin e mirëqenies popullit shqiptar”, qeveria komuniste do të deklaronte si objektiv primar transformimin e Shqipërisë nga “një vend agrar e gjysmë feudal” drejt shndërrimit të tij “në një vend agraro-industrial”, për të kaluar më vonë drejt një stadi “industrialo-agrar”, i cili pritej të konsolidohej në vitet 1980 — ‘90. Sipas kësaj skeme të zhvillimit të vendit, të frymëzuar totalisht nga strategjitë dhe politikat e BRSS-së të Stalinit, prioritet do t’i jepej industrisë në raport me bujqësinë, që gjithsesi konsiderohej si “dega bazë e ekonomisë”, dhe brenda industrisë, prioritet do të kishte industria e rëndë që përbënte thelbin dhe ambicien kryesore të politikës së “industrializimit socialist” të vendit. Duhet pranuar se si pasojë e këtyre politikave ekonomike u arritën disa rezultate pozitive: industria arriti të katërfishojë prodhimin e para Luftës II Botërore; u zhvillua nxjerrjen e naftës dhe mineraleve të tjera; u rikonstruktuan një pjesë e rrugëve dhe urave; u zhvillua industria tekstile dhe ajo ushqimore etj. Në vitin ‘60, industria kontribuonte më shumë se 50% në PBB të vendit dhe Shqipëria shpalli me krenari “realizimin e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit”.

Por këto suksese, në pjesën dërrmuese të tyre u favorizuan nga ndihmat dhe kreditë e shumta që Shqipëria përfitoi nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të bllokut komunist. Mjaftojnë disa shifra për të kuptuar situatën: në periudhën 1947 — 1959 midis qeverisë shqiptare dhe asaj sovjetike u nënshkruan 16 marrëveshje kreditimi me një vlerë 244 milionë rubla. BS-ja dhe vendet e tjera të kampit socialist i patën akorduar Shqipërisë 433 milionë rubla kredi, nga të cilat u përdorën 316 milionë rubla ose 73%. Në pesëvjeçarin 1951 — 1955, kreditë përfaqësonin 90%



të importeve, kurse në pesëvjeçarin II, 1956 — 1960, rreth 47%.

Ndihmat dhe kreditë e BS-së dhe vendeve të kampit socialist kanë qenë shumë të rëndësishme për kohën, pasi vendi kishte nevojë për gjithçka, deri edhe për sigurimin e bukës. Ato ndikuan për kthimin nga një vend agrar i prapambetur në një vend agrar industrial në vitin 1955 dhe ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit në vitin 1960.

Prishja e marrëdhënieve të Shqipërisë me BRSS-në dhe dalja e saj de facto nga kampi socialist mbas viteve ‘60, i ridimensionoi së tepërmi ambiciet dhe strategjinë e saj të industrializimit. Në politikat e zhvillimit të vendit hyri gjithnjë e më shumë koncepti dhe praktikat e “mbështetjes vetëm në forcat e brendshme”. Megjithatë, në periudhën 1958 — 1978, vendin e BS-së dhe kampit socialist e zuri Kina, e cila gjithashtu dha një ndihmë të konsiderueshme për “ndërtimin e socializmit në Shqipëri”.

Nga viti 1954 e deri më 1975-n, përveç ndihmave dhe granteve të shumta, me RP të Kinës u nënshkruan dhe 17 marrëveshje kredie, në monedha të ndryshme, si: 1320 milionë në rubla, 58.4 milionë në USD etj. Gjatë kësaj periudhe u ndërtuan dhe veprat më të mëdha të industrisë të cilësuar si “ajka e industrisë shqiptare”: kombinati metalurgjik në Elbasan, disa hidrocentrale, një rafineri e madhe naftë, zhvillimi i industrisë nxjerrëse e përpunuese të kromit, hekur-nikelit dhe bakrit, disa uzinave për prodhimin e plehrave kimike, bitumit, çimentos, tullave etj., uzina të industrisë së lehtë e përpunuese etj. Në vitet 1960 — ‘75, rreth 60-70% e tregtisë së jashtme shqiptare zhvillohej vetëm me Kinën.

Në vitet 1970 — 1980, ekonomia shqiptare pati momentin e vet më pozitiv të rritjes ekonomike nën regjimin totalitar, për shkak të përfundimit të veprave të mëdha infrastrukturore si disa akse kryesore të rrugëve nacionale dhe HEC-eve të mëdha mbi lumin Drin. Gjithashtu në këtë periudhë hynë në funksion disa nga fabrikat e mëdha të pasurimit të mineraleve të nëntokës. Mirëpo një dekadë më pas, sidomos në gjysmën e vitit 1980, ekonomia shfaq

qartë ngadalësimin e ritmeve të rritjes, për shkak se potencialet nga burimet e brendshme kishin mbaruar. Me një cikël të ngjashëm, po përballej edhe ekonomia e vendeve të Europës Lindore. Prishja përfundimtare e marrëdhënieve me Kinën në vitin 1978, në vend që të stimulonte kërkimin e partnerëve të tjerë të vendit, apo ta detyronte qeverinë shqiptare të hidhte sytë nga Perëndimi, u transformua në një autarki totale.

Duke filluar nga viti 1976, në emër të “ruajtjes së pavarësisë politike e ekonomike” dhe “mbështetjes në forcat tona”, u adoptuan tri kufizime tërësisht ideologjike: në mbështetje të nenit 28 të Kushtetutës, u ndalua çdo lloj kredie apo borxhi nga jashtë; u kufizuan në mënyrë drastike të gjitha importet, “me përjashtim të atyre që konsideroheshin absolutisht të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe nevojat sociale”; disa nga vendet më të zhvilluara të botës “të cilësuar si kapitaliste, revizioniste apo sioniste” si SHBA-ja, Anglia, Bashkimi Sovjetik, Izraeli, Afrika e Jugut, Gjermania Federale etj., u përjashtuan nga axhenda e marrëdhënieve tregtare. Por vitet ‘80, regjistruan fillimin e rënies me shpejtësi të niveleve të rritjes ekonomike. Rritja ekonomike vjetore që arrinte mesatarisht në 5-6% në vitet 1970 — 1980, ra në 1% në dekadën 1980 — 1990. Shqipëria kishte arritur tashmë në fund të mundësive të fazës ekstensive dhe “rrugëve të reja e origjinale të zhvillimit” të eksperimentuara prej saj. E privuar nga kapitalet e huaja, të cilat konsideroheshin si “instrumente skllavëruese” dhe ndaloheshin me Kushtetutë, e arritur në limit të rezervave dhe mundësive të saj të brendshme dhe njëkohësisht si pasojë e efekteve të gabimeve të akumuluar në shumë vendime e zgjedhje thelbësore të politikave të saj ekonomike, rritja ekonomike po shkonte afër zeros.

Ekuilibrat makro-ekonomikë ishin tronditur rëndë dhe si pasojë e subvencioneve të mëdha që përpiqeshin të mbulonin mungesën e eficiencës së sektorit publik, deficitit buxhetor arriti 5.9% më 1988-n, 9.5% më 1989-n dhe 16,6% më 1990-n. Ekonomia dhe financat shqiptare ranë në kolaps të plotë dhe pa asnjë shpresë rimëkëmbjeje.

Globalizimi, mit apo realitet? Ka shumë debate, qëndrime dhe përkufizime rreth një koncepti shumëdimensional...

A.C:Nëse sot në botë ka një debat për të cilin opinionet dhe qëndrimet janë të shumta e mjaft të ndryshme, ky është padyshim “efekti i fenomenit të globalizimit në ekonomitë kombëtare dhe nivelin e jetesës së popullsisë së çdo vendi”. Gama e opinionëve fillon me vlerësimin se globalizimi përbën “një oportunitet historik për zhvillim” dhe përfundon me konkluzionin se ai po prodhon “shkatërrimin e kulturave dhe produkteve në shumicën dërrmuese të vendeve të botës si pasojë e konkurrencës ndërkombëtare dhe dominimit të disa vendeve mbi të tjerat”. Opinione të drejta apo të gabuara? Vështirë se mund të jepet një përgjigje a priori për këtë fenomen kaq kompleks. Vetë fakti se në të gjithë botën, çdo ditë e çdo muaj, “çështja globalizim” vazhdon të debatohet, vlerësohet e rivlerësohet, anatemohe apo glorifikohet, injorohet apo vihet në pedestal, dëshmon se sa kompleks e gjithëpërfshirëse është kjo dukuri.

Në konceptet dhe përkufizimet e sotme, termi “globalizim”, i parë në tërësinë e tij, nënkupton zhvillimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet njerëzve, ideve dhe informacionit, aktiviteteve ekonomiko-financiare e tregtare, atyre politike e kulturore në shkallë planetare. Si pasojë e përhapjes dhe prezencës gjithnjë e më të gjerë të këtij fenomeni në çdo aspekt të jetës së secilit, toka po konsiderohet gjithnjë e më tepër si një “fshat planetar” ku ndërthuren e bashkëveprojnë ide, ekonomi, kultura e mjedise të ndryshme. Por, megjithatë, një pikëpyetje e madhe qëndron mbi mendjet e të gjithëve: globalizimi është një fenomen real apo thjesht një mit i krijuar nga njeriu? Që nga shfaqja e parë e tij në vitin 1962, termi “globalizim” ka kaluar nga statusi i përdorimit të përditshëm si zhargon në statusin e një klisheje. Revista e njohur “The Economist” e ka quajtur “si fjalën më të konsumuar dhe shpërdoruar të shekullit XX dhe XXI”. Edhe Johannes Varwick, profesor i shkencave politike në Universitetin e Kiel-it në Gjermani, thekson se globalizimi “është shndërruar tashmë në një fjalë të rëndësishme, e cila prej disa kohësh po përdoret në mënyrë inflacioniste në debatet politike, publicistike dhe shkencore duke u konsideruar këtu nga njëra anë si ‘kërcënim’, nga ana tjetër si ‘shans’”. “Është e qartë për të gjithë se në historinë e njerëzimit, asnjë fjalë e vetme nuk ka sintetizuar më shumë fenomene, njerëz e territore sesa kjo fjalë magjike.

Kur Princesha e Uellsit, Ledy Diana, humbi jetën në mënyrë tragjike në aksidentin e Parisit më 31 gusht 1997, u gjet përsëri një mënyrë për ta implikuar globalizim si sintezë në pasqyrimin e kësaj ngjarjeje. Ja si e ilustron globalizimin në një nga editorialet e saj revista “Alternatives Economiques”: “Globalizimi është një princeshë angleze dhe miku i saj egjiptian që humbën jetën në një tunel francez, ndërsa po udhëtonin me një veturë gjermane me motor holandez që kishte një shofer belg, ndërkohë që po ndiqej këmba-këmbës nga paparacë italianë të hipur në motorë japonezë”. Për disa globalizimi shikohet si një lloj nirvane apo iluminimi, një gjendje e përgjithshme ku mbretëron paqja dhe prosperiteti universal, një vend i shenjtë ku të gjithë duhet të falen e të luten për një të ardhme sa më të mirë; për disa të tjerë globalizimi është një ferr i vërtetë, një skëterrë, një kaos shkatërrimtar që duhet dënuar dhe zhdukur menjëherë n.q.s. duam që njerëzimi të vazhdojë të ekzistojë. Ja si shprehet njëri prej tyre: “Planeti tokë i ngjan sot një avioni ‘Boeing 747’ që është duke fluturuar në një zonë të fortë turbulence e shkaktuar si pasojë e efektit të përbashkët të globalizimit dhe ndryshimeve teknologjike. Ne të gjithë jemi pasagjerë në këtë avion: globalistë e antiglobalistë, ekologjistë e natyralistë, integristë e nacionalistë etj. Situata është e menaxhueshme dhe avioni mund ta kalojë këtë zonë të rrezikshme dhe ta evitojë katastrofën, por me kusht që të merren masa speciale. Por fatkeqësisht, avioni nuk ka pilot. Ai

shtyhet sa majtas-djathtas nga korrente të forta ajri dhe rreziku që të bjerë në tokë është shumë i madh”.

Megjithatë, ka dhe një grup apo rrymë e ndërmjetme që e shikon më me realizëm dhe pa emocione globalizmin duke e konceptuar dhe përkufizuar atë si një “udhërrëfyes logjik” që e ka shoqëruar njerëzimin gjatë gjithë historisë së tij, si një tendencë që është intensifikuar dhe përshpejtuar veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, për t’u shfaqur tashmë lakuriq me avantazhet dhe disavantazhet e saj. Ashtu si klima ka ndikuar e formatuar mjedisin e tokës gjatë gjithë periudhave të historisë, ashtu edhe ndërveprimi ndërmjet kulturave e llojeve të ndryshme të civilizimeve e shoqërive njerëzore gjatë dhjetëra shekujve ka rezultuar me një integrim në rritje të vazhdueshme duke “prodhuar” atë që sot quhet “komuniteti njerëzor botëror”. Shumë ekspertë dhe studiues të fenomenit të globalizimit dhe shtrirjes së tij kanë dhënë e vazhdojnë të japin përkufizime sinjifikative në lidhje me gjerësinë dhe kompleksitetin e kësaj dukurie. Në librin “Globalizimi virtual” autorët e shikojnë “globalizimin kudo. Për t’u bindur për këtë mjafton të ndezësh një televizor ose një kompjuter, të hysh në një McDonald’s ose të vishesh te



GAP. Nga programet informatike Windows te seritë televizive, nga hamburgeri te xhinset, globalizimi shfaqet në të gjitha format, materiale dhe virtuale. Ai shpërndan ide, koncepte, inovacione dhe simbole që statistikat e kanë vështirë t’i pasqyrojnë”.

Sipas Pierre Calame, autor i disa librave mbi globalizimin dhe qeverisjen globale, “shkalla e ndërvërsisë që lidh njerëzit, diferencat kulturore dhe gjithë biosfera ka ndryshuar rrënjësisht gjatë dy shekujve të fundit. Ajo që ndodh në një cep të planetit ka ndikim në të gjitha pjesët e tjera të botës, sepse informacioni, njerëzit, stilet e jetës dhe grupe të ndryshme popullsie qarkullojnë dhe lidhen ndërmjet tyre si kurrë ndonjëherë më parë. Në fund të shekullit XX, kombet, shtetet, kultura, biznesi dhe ndërmarrjet, tregjet dhe demokracia përfaqësuese janë bërë praktikisht koncepte universale”. Stiglitz e përkufizon globalizimin si “një integrim shumë të ngushtë të popujve dhe vendeve të botës, i cili ka realizuar, nga njëra anë një reduktim të konsiderueshëm të kostove të transportit dhe komunikimit dhe, nga ana tjetër, shkatërrimin e barrierave artificiale në qarkullimin ndërkufitar të mallrave, shërbimeve, kapitaleve,

njohurive dhe njerëzve”. Për shumë ekonomistë që e kanë analizuar thellësisht globalizimin, në vetvete, ai nuk është një dukuri negative. Globalizimi ka krijuar mundësi fantastike për shpërndarjen e dijeve, informacionit, teknikave dhe teknologjive nga më modernet e produktivet, modele të rritjes ekonomike dhe zhvillimit duke ndihmuar kështu në përmirësimin e nivelit të jetesës së shumë rajoneve e popujve të botës. “Globalizmi është potencialisht shumë efektiv dhe i aftë që të pasurojë çdo banor të planetit, veçanërisht më të varfrit”.

David Dollar, ekonomist për politikën e zhvillimit në Bankën Botërore, e përshkruan globalizimin si një “tren me shpejtësi të madhe për të cilin të gjitha vendet e botës duhet të ndërtojnë platforma specifike që të kenë mundësi të hipin. Kjo platformë është një indikator që tregon nëse vendi shkon mirë”. Sipas Dollar-it, kjo nënkupton të drejtat e pronësisë, ndërtimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, edukimin dhe shërbimet shëndetësore bazë për të gjithë, infrastrukturë cilësore portesh, aeroportesh, rrugësh e hekurudhash, doganash etj.

Në rastet kur qeveritë “nuk arrijnë që ta ndërtojnë si duhet këtë platformë, ose kur organizatat ndërkombëtare nuk japin kontributin e kërkuar dhe pritur prej tyre në këtë aspekt, shumë popuj e vende të botës mund të mos i hipin dot trenit të globalizimit dhe të përfitojnë nga shpejtësia e tij”. Akoma më interesant është këndvështrimi i Thomas Friedman, gazetar i gjeopolitikës në “New York Times”, i cili shkruan se “globalizimi nuk është një fenomen modern, por ne ndodhemi aktualisht në versionin e tretë të tij. Globalizimi 1.0 është ai i shkëmbimeve ndërmjet kombeve, i cili fillon me Kristofor Kolombin dhe mbyllet me fillimin e revolucionit industrial. Globalizimi 2.0 që shtrihet në periudhën 1800 — 2000 është ai i ndërmarrjeve dhe kompanive, që në kuadrin e rritjes së tyre ekonomike, shumëfishuan, transportuan dhe shpërndanë produktet dhe modelet e tyre organizative në gjithë planetin. Globalizimi 3.0 është ai i sotmi, i universit virtual, i cili vë në dispozicion të çdo individi burimet e planetit dhe kjo, vetëm me një klikim të mausit të kompjuterit”. Th. Friedman konkludon se “nëse ju nuk kuptoni gjë nga globalizimi, në fakt ju nuk kuptoni gjë nga kjo botë”. Duket sikur gjithçka në planetin tonë është mbështjellë nga rrjeta e globalizimit. Zygmunt Bauman, një nga sociologët më të njohur të angazhuar në problematikën e globalizimit e shpreh në mënyrë mjaft lakonike situatën e sotme: “Globalizimi është i pashmangshëm dhe i pakthyeshëm. Ne jetojmë tashmë në një botë të ndërlidhur e të ndërvarur në shkallë planetare. Gjithçka që ndodh në një vend të saj prek jetën dhe të ardhmen e të gjithë njerëzve kudo që ndodhen. Kur vlerësojmë apo gjykojmë masat e adoptuara në një mjedis të dhënë, ne duhet të marrim patjetër parasysh reagimet dhe pasojat në pjesën tjetër të botës. Asnjë shtet apo territor sovran, sado i gjerë, sado i populluar, sado i pasur që të jetë nuk mund të mbrojë i vetëm kushtet e jetesës, sigurinë, prosperitetin afatgjatë, modelin social apo dhe vetë ekzistencën e qytetarëve të tij. Varësia jonë e përbashkët shtrihet tashmë në çdo skaj të planetit”. Këtij konceptimi i bashkëngjitet dhe sociologu i shquar Anthony Gidens, kur nënvizon se “globalizimi shpreh intensifikimin e marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes së cilave vende të largëta mbajnë lidhje me njëra-tjetrën, në mënyrë që ngjarjet në një vend të karakterizohen nga të njëjtat procese sikurse dhe në një vend tjetër shumë kilometra larg dhe anasjelltas”. Por konkluzionin dhe përmbledhjen më të mirë duket se e përkufizon Laurent Carroue, ekspert i gjeografisë ekonomike dhe globalizimit, që vlerëson se “globalizimi aktual, ky proces gjeohistorik i përhapjes progresive të kapitalizmit në shkallë planetare, është në të njëjtën kohë një ideologji – liberalizmi, një monedhë – dollari, një model – kapitalizmi, një sistem politik – demokracinë, një gjuhë – anglishten”.

Pjesë nga libri “Udhëtim në tre kohë”


IN MEMORIAM

HANS JOACHIM LANKSCH

“NUK BËN TË VDESËSH I URITUR...”

Nga Anna Kove

30 janar. E premte. Ora 15:30. Është ftohtë dhe Munihi është i mbuluar me borë. Jam në ditën time të fundit këtu, në të vetmen pasdite vetëm për veten, jashtë planit të përbashkët të seminarit. E lirë për të marrë vendimin se ç'do të bëja me pasditen time, një takim i paracaktuar jo rastësisht më çoi në një lagje shumë të njohur për vizitorët e këtij qyteti të rrallë: “Münchner Freiheit”, shqipëruar “Liria e Munihut”.



Në këtë qytet të shijon liria, sidomos në këtë lagje ku banojnë kryesisht studentë nga e gjithë bota dhe afër të famshmit atraksion turistik: ‘Englische Garten/ Kopshti anglez’. Por liria e kësaj pasditeje do të kishte, çuditërisht, këtu në Munihi shijen e lirisë së bjeshkëve shqiptare, shijen e mikpritjes, dashamirësisë, bujarisë dhe fisnikërisë së Hans Joachim Lanksch-it.

Më priti me derë hapur, më mbajti pallton si një xhentëlmën i vërtetë, më udhëhoqi në dhomën e ndenjjes, drejt së cilës duhet të më përshkonin sytë kodra e male librash, shumë prej tyre edhe në shqip. Mik i shumë miqve të mi, unë tani isha bërë me katër sy, për të fiksuar çdo detaj, e bindur se i isha “borxhlie” edhe kureshtjes së tyre. Një vizitë te një mik gjerman në atë orë të pasdites do të thoshte se ishte koha për të ndarë kafënë e pasdites dhe emocione të përbashkëta. I zoti i shtëpisë dhe i mendimeve të mia në ato çaste po përgatiste kafënë.

Me një humor të çlirët dhe fin, më tha se do vonohej pak, pasi nuk kishte aparat elektrik kafeje dhe i duhej ta përgatiste kafënë gjermane në mënyrë paksa primitive në një kanë filtri. Pse duhej të shqetësohej për këtë, unë vija ndërkohë nga një vend “primitiv”...

Me filxhanët e kafesë në dorë dhe një tabaka të mbushur plot me ëmbëlsira, më pyeti në doja sheqer... I thashë se e pija filtër-kafenë pa sheqer. Sa mirë, m'u përgjigj. Sikur ta dija! Ne nuk mbajmë fare sheqer në shtëpi... dhe qeshi fort. Po sikur ta kisha kërkuar me sheqer? Qesha edhe unë fort. Kjo mjaftoi që emocionet e mia të kalonin në periferi të ndjesive në ato çaste.

Koha nuk e di si rendi aq e pashpirt me bisedat tona për kohën time në Gjermani, vizitat në teatro, ekspozita, shtëpi shkrimtarësh etj., për përkthimet e mia, duke më inkurajuar në përkthimin e Paul Celan-it, për jetën në Shqipëri, për Shkodrën, ku kisha jetuar gjatë, për letërsinë shqipe dhe veçanërisht për Martin Camajn dhe vargjet e tij.

Përkthyes jo vetëm i një autori, por, përmes tij, i një letërsie të tërë, i letërsisë së shkruar në gjuhën e bukur të gegnishtes, ai ishte dy herë gjigant, do të thosha unë, dhe besoj se gjithkush që ka lexuar dhe shijuar Camajn, ndan të njëjtin mendim: ta përkthesh atë në një gjuhë të huaj, kur brenda gjuhës së kombit të tij është pothuaj gjuhëhuaj, të përkthesh “shejzat” poetike të të madhit Martin Camaj, duhet të të ketë bërë shenjë vetë Zoti!

Që nga ajo ditë janari në Munihi kaluan dhjetë vjet dhe Hans Joachim Lanksch-in e kishim pranë edhe falë rrjeteve sociale; të papërtuar për të diskutuar me ne të gjithë çdo problem të letërsisë dhe gjuhës shqipe, që i takonte sigurisht sqimës së tij. Ishte aty të na përkujtonte shpesh Camajn, Shkrelin, Podrimën, Trebeshinën. Personalisht, të më inkurajonte e të më ndihmonte në përkthimet e mia të poezive të Celan-it e së fundmi edhe të Rose Auslaender-it, disa poezi të së cilës ai vetë i kishte sjellë kohë më parë në shqip. Gjithmonë fisnik, gjithmonë i gatshëm me përgjigjet e tij të pakompromisa me parimet e tij.

Për njerëzit që na duan ne dhe vendin tonë, që kanë përçarur shpirtin e këtij vendi përmes letërsisë në vendit të tyre, me gjak të zemrës së tyre, mirënjohja nuk mjafton. 30 janari 2009 ishte data që hyri në historinë e takimeve të mia me njerëz jo të zakonshëm, të cilët na bëjnë të ndihemi edhe ne të tillë pranë tyre.

“Nuk bën të vdesësh i uritur...” - kështu fillojnë vargjet që Ali Podrimja i dedikoi njeriut Lanksch. Nuk do të doja të vdisja me urinë e mosnjohjes së shpirtit dhe mikut të madh të poezisë shqipe, të gjuhës shqipe, të shqiptarëve...

U prehsh në paqe, Hans! Jam me fat që të njoha. Jemi me fat që të kishim...

Festivali Ndërkombëtar i Filmit

SHQIPËRIA NË KANË ME KINEASTIN E RI, ERENİK BEQIRIN

Regjisori Erenik Beqiri i është bashkuar Festivalit të Kanës. Si rrallëherë një artist i ri shqiptar arrin, që me filmin e tij, “Furgoni” të lërë pas 4240 realizime të kinematografisë ndërkombëtare edhe të përzgjidhet mes tyre, si një ndër 11 më të mirët. Kineasti ka bërë të mundur, që filmi shqip të prekte për herë të parë kategorinë e filmave të shkurtër në Festivalin e Kanës në edicionin e saj të 72-të.

Subjekti i filmit me metrazh të shkurtër “Furgoni” ka në qendër historinë e një djali të ri, i cili rend në kërkim të lirisë së tij. Për këtë i riu merr rrugën si refugjat. Por, për të s’do të jetë e lehtë për djaloshin, i cili për t’u larguar nga Shqipëria do t’i duhet të përfshihet në një ndeshje jo të zakonshme. E kjo ndeshje “boksi” zhvillohet në një furgon, derisa në fund të udhëtimit zbulohet se kush ka fituar. Në role kryesore në këtë film (prodhim shqiptaro-francez) luajnë aktorët:

Phenix Brossard, Arben Bajraktaraj dhe Afrim Muçaj. Filmi “The Great Warrior Skanderbeg”, me regji të Sergei Yutkevich bashkëpunim i Shqipërisë edhe Bashkimit Sovjetik, kandidat për “Grand Prize”, por që fitoi “International Prize” dhe “Special Mention” për regjinë në Festivalin e Filmit në Kanë, në vitin 1952.


Ndërsa, “Slogans” i Gjergj Xhuvanit, u vlerësua me “Prix de la Jeunesse du film étranger” (2001). Filmi “Të vdekurit s’vdesin” (The Dead don’t die) m regji të Jim Jarmusch çeli Festivalin e Kanës.

Ndërsa, president i jurisë është përzgjedhur regjisori Alejandro Gonzalez Inarritu, fitues i çmimit “Oskar” me filmat “Kthimi” dhe “Birdman”. Ndërsa, anëtarët e tjerë

“

Filmi shqiptar prek për herë të parë kategorinë e filmave të shkurtër në Festivalin e Kanës.

janë; aktorja Elle Fanning, aktorja Maimouna N'Diaye, regjisori Kelly Reichard, regjisori Pawel Pawlikowski, skenaristi Enki Bilal, regjisori Robin Cambillo, autorja Alice Rohrwacher dhe autori Yorgos Lanthimos. Në garë për “Palmën e Artë” janë 21 filma. Mes tyre; “The Dead Don't Die” i Jim Jarmusch-it, “Douleur et gloire” i Pedro Almodovar-it, “Il Traditore” i Marco Bellochio-it etj.



Një tekst i panjohur i Mjedës mbi poezinë është botuar në revistën “Shkëndija”, e përkohshme letrare dhe artistike, viti I, nr. 8-9, shkurt-mars 1941, drejtuar nga Ernest Koliqi. Ndërsa shkrimi shënohet se është “xjerrë prej shkrimesh së pabotueme të Dom Ndre Mjedës nga Ndue Doçi”

PËRMBI POEZI PËRGJITHËSISHT

Nga Dom Ndre Mjeda

Natyre e poezisë

Disa thonë se poezija asht të shprehurit e ndjesivet të zemrës e të përfytyrimit (fantazisë). Por me kaq nuk diftohet ndryshimi i poezisë e i gojtarisë; e shumë shumë kishte me përshi të shprehurit poetik. Por kena e poezisë nuk pështetet mbë të shprehun e në stil, por ma fort në send.

Tjerë kujtojnë se poezija asht giasimi me natyrë. Por giasimi me natyrë asht edhe mbas Aristotelit, një mjet i poezisë, por jo vetë kena e saj. Mirë se në poezi dramatike e epike shifet giasimi me natyrë, por në poezi lirike ku gjindet ky giasim? Ata qi thonë se poezija asht një hartim, një sendërgjim, nuk janë një fjalë mbi se shka ashtu hartimi e sendërgjimi. Mbas mendes së tyne hartim e sendergjim don me thanë herë një përrallë, një gja e trillueme prej mendes, herë shenjon trajtimin e poemit.

Disa tjerë tue folë për poezi kujtojnë se masa (metri) asht një gja e domosdoshme për poezi. Por ka shprehje të lidhuna me masë, me rroke, theksa e rima qi s'mund të thohen përnjimend poezi; auktorët e tyne munden me u thanë vjershatarë, por jo poetë.

E thomi edhe na se masa e plotson poezin, por nuk asht një gja e domosdoshme e natyrës së saj.

Gjithëkush e ndien se pos masës lypet diçka tjetër për me ba poezin. Prandaj shumë herë thotë Aristoteli se një prozë filozofike a historike vu në vjershë, nuk asht poezi. E pse? Pse me gjithë qi asht vu në vjersha, i mungon përftimi poetik. Filozofi e historiku nuk thomi se s'janë poetë, pse nuk shkruajnë në vjersha, por pse sillen mbi një landë qi nuk përkon me atë të poezisë, mbasi secili ndër këta të dy ka për shëllim me kallxue e shtjellë të vërtetën e sendevet, kurse poeti ka për shëllim me shemëllye bukurin, atë shprehë.

“Pulchra sunt quae visu placent”; për bukuri këtu merret vesht çdo send qi, sa të kuptohet siell kënaqje. Prandaj s'do me thanë vetëm një send t'ambël, të hieshëm, të shëndritshëm por edhe të naltueshëm, të randsishëm e qi bindë. Prandaj ma mirë caktohet poezija tue thanë se asht të shfaqurit e bukuris me një të shprehun të përfytyrimit (fantazisë), ma të shumën e herës me masë.

Bukurija mundet me kenë landa edhe e tjera arteve të bukura, si e pikturës e skulpturës, por menjatë të shprehun qi i del prej tugës së zemrës e prej fuqis së përfytyrimit.

Të shprehurit poetik të bukurisë

Në dy mënyrë poeti mundet me shprehë bukurin, d.m.th: a tue përshkrue sendet e bukura të natyrës, a tue krijue me mend të vet një send përnjimend të bukur. *Ut picture poesis*, ka thanë Horati. Por ka një ndryshim, pse piktori nuk mund të shfaqë veçse fytyrën si me thanë të njëj sendes, e pikën e kohës së njëj veprimi; përkundra poeti shfaqë një send nën shumë pikëpamje, me xjerrë shka nuk shef syni, e mundet me e përshkrue njënen mbas tjetres pikëpamjet e atij sendit.

Prandaj a fort të vishtirë qi poeti tue përshkrue prej natyre mos ta stolisin disi atë gja send, sidomos në kjoftë mendehollë. Prandaj nuk i lypet poetit të jetë aq besnik sa përshkruesit (kopistit) përse poeti në punë të vet do t'u përgiajnë sendeve e jo t'i përshkruajë. Giasimi lypë qi sendja t'i përgiajnë sendes, por qi të jetë njënji me të.


Edhe mënyra e të shprehurit në këtë pikë ka randsi. Qishtu Virgjili me një mjeshtri e hollësi të pa shoqe të shprehuri ka mbërri me përshkrue fortunën e detit. Një tjetër mënyrë fort ma e çmueshme asht një hartim a krijimi i mendes, ku të shëndrisi drita e një formës së naltë të idealit. Në këtë krijim danë fuqija e mjeshtrija e poetve.

Në mënyrë të parë qi thamë sypr, nuk shifet një poet i vërtetë, por një vjershtar; në të dytin gjejmë shka lypë Horati për një poet: Ingenium cui, sit, meus divinius, alque os Magna sonaturum, des nominishuins honorem (Satyr. L.I.4.vs.43)

Ashtu si Qiqeroni thotë se poeti e ka zotësin prej natyre, zgjodhet prej fuqis së mendes e asht frymzue prej fryme gati hyjnore.

Mbasandej pse parasohen aq shpesh poetët me bletët? Të ndiejmë Lukrecin:

“Floriferis ut apes in sallibus omnia lipant”
Omnia nos item deposcimur aurea dicta”
“...ego apis matinee
More, modoque
Grata carpentis thyme per laborem
Phurimum, circa nemus uvidique
Tiburis ripas, operosa parvus
Carmina fingo” (Odarum. L. IV.28)



Njimend se Horati me këto vjersha ka dashtë me thanë se ai kapei ma fort me sende të hartueshme se me sende të nalta; megjithë këtë mbë se pshtetet këjo shemeltire?

Qe me pak fjalë: Sikurse blea prej epshi së vet tui i hjedhë andej e këndej, nuk ndalet me pleh e në baltë, por kërkon lulishtet, nuk ulet mbë çdo bar, por kërkon lulet; lismen, shërbelën e tjera bimë erëkandshme e prej gjithë kësosh mbëledh atë mjaltë aq të shieshme, ashtu poeti tue injirue me sy këtë lulishten e botës nuk do të nguli në sende të përçudshme as s'do të shemëllye zgaqin e Shoqënis, por do të zgjedhi sendet ma të bukura, ma të ndershme, ma të shieshme, por edhe qi ma fort të përkojnë me arësye e këto do të shfaqin në vjershi të vet; ashtu edhe më shpejt të mendes me u hjedhë në të tana anët, me rrnuë gjithëshka, me mbëledhë, me gjetë shka mund të vijë në çdo rasë, e, prej gjithë aso sendesh me përftue në mende të vet ndonjë hartim të ri; kjo asht puna e poetit.


Prandei poeti e çdo mjeshtrë i arteve të bukura për me përftue në mend qi do ta bajë, vepron në një mënyrë të vetme. Populli i imë shef sendet qi e rrethojnë, e e ndalë synin në të gjitha pa dallue njënen prej tjetres: e nd'i baftë përshtypje ndonji aso sendesh, këjo asht një përshtypje qi mund ta ket gjithëkushi e nuk kalon dobin e jetesës. I dieshmi a filozofi soditë sendet e ndodhit e prej sosh xir ligjë të përgjithta, naltohet në parime të shkoquna, e ju paraqet edhe tjerëvet për mësim. Poeti prej sendesh qi shef naltohet edhe ai në parime të shkoquna e i parason me atë shembull bukurije qi ka vetë në mend, e me ndimë të hollësisë së mendes e së fantazisë përban një përftesë teknike; por mbasandej e shfaqë si gja me korp. d.m.th, të veshun me ndo' send të hartuem, o me ndo' shembull, o me ndo' përfytyrim qi të kënaqin e të argtojnë ata qi e shofin e e këndojnë.

Edhe për këtë arsye nuk merret vesht si mundet m'u thanë se poezija asht një giasim i natyrës: 1) Pse poezija ma të shumën e herës, merret me sende vërtetë-giasë, qi u përshtatën sendeve të natyrës... 2) Pse vepra poetike asht përftimi i një mendes së mësue me sende të bukura; por mendja s'mund të bëgatet pa shqyrtue sendet e natyrës. 3) Pse vepra poetike ju shtrohet shi njatyne ligjeve sidomos kah shehimi i njësisja, qi ju shtrohen sendet e natyres.


Shëllimi i poezisë

Horati e përshinë shëllimin e poezisë me këto vjersha:

“Ant prodesse volunt ant delectare poetae: Ant sianul et incunda, et idonea dicere vitae” (Ars. Poet. 333.34) Kurriga qi lypë poezija nuk asht shtazore, por si e lypë njerëzija e arësyeja: nuk asht një kënaqje qi ta poshtnojë nierin, por qi ta naltojë. Shkon pra kundra rregullash të artit kush ban një poezi të fliqtë, përse me veprë të vet stolisë një kënaqje qi nuk asht e nierit, por e shtazëve, e qi asht murtaja ma e rrebtë e helmi ma rrënues i shpirtit. Por mirë e me vend foli për këtë punë At Famjan Strada, i Shoqënis së Jezuit



në ligjeratë poetike të vet: “Gjithë sa herë më bje me ndeshë ndo’j libër të fligjtë e të turpshëm, e përvec vedin ç’rrezik e ka shty auktorin me shkruar atë veprë të ndytë e të poshtër, nuk gjejë arsye tjetër veçse njenën ndër këto të dyja. Ndo’j herë prei veprës hetoj frymën e natyrën e shkrimtarit: pse kam xanë prej Aristotelit qi prodhimet e poetve thohen pjella e tyre; e se nuk i donë prindja fëmijet e vet ma fort se poetët librat e vet. Prandej kur shof ndo’j send të fligjtë, më vjen me mendue se pjella e gianë prindit e se prej një mendes së fligjtë e së poshtër s’ka mujtë me dalë pjellë ma e bukur e fisnike; e në kjoftë se jam në gabim tui mendue këso dore, megjithëse, fort rrallë mund të ndodhin: përse të vëluemit e atyne sendeve të fligjta në mend, të shkruemit, të thanunit, si s’kanë me fligjë mendën e si s’ka me u ndragë me at llom qi ka nder duerë, i siellem arësyes tjetër, e atë shkrim të fligjtë, ja pshtes pazotësis së shkrimtarit, e ma të shumën e herës nuk gabo.



Përse me ba një poezi pa dhunue artin, të kënaqi përnjiheri e të sjelli dobi, asht një fatbardhësi mendje aq e madhe, sa (si me i këndellë nd’at send vete Zotynë fuqit e nierit pat me thanë dikur Sokrati se nd’atë punë njeriu e difton vedin latë të vërtetë të Tinëzot), tue ba një veprë të dejë për një qi i thomë, ketë punë, e në tjetër anë tui pa pazotësin e mendes së vet m’u kapë me sende aq fisnike qi ta bajnë ndo’j veprë e cilla të joshi kah e mira e mbara e tue e pëlqye të mëdhejvet e të vogjelvet, marrin rrugën tjetër e tui mbëledhë punë jo fort të vishtira, dokrra të tinglueshme të ndraguna ndër filigshti t’armëvet e të dashtënis, aq e tërhjekin e e përkëndellin atë pjesë nieri qi ma udobtë tërhqiqet e aq hinë në shpirt zgaqit të nierzisë së gjindës që janë mbas mendes së tij, sa i rrenë uzda ja se kanë me pasë prej asi zgaqi qi thamë, se ndragun prei këso gieilimesh plehuore, atë lavd e nam, qi s’mund të presin prei zotësis së mendes së vet.”

“Prandei poeti e çdo mjeshtër i arteve të bukra për me përfutue në mend qi do ta bajë, vepron në një mënyrë të vetme.

Akademia Marubi

LLESHANAKU, VELO DHE ÇASHKU NË NJË BISEDË MBI CENSURËN DHE VETËCENSURËN NË KOMUNIZËM

Një grup intelektualësh shqiptarë dhe të huaj u mbledhën javën që shkoi për të folur për censurën dhe vetëcensurën në Shqipërinë komuniste, për kufizimin e lirisë së fjalës dhe të mendimit në veprat artistike të asaj kohe.

Poetja e njohur shqiptare, Luljeta Lleshanaku, dha shembuj të censurës në kohën e komunizmit të shkrimtarët dhe poetët, të cilat në ato kohë konsideroheshin si gabime ideore. Sipas Lleshanakut, letërsia ishte shumë e varfër në atë kohë dhe kishte mungesë të theksuar librash, aq sa njerëzit rilexonin disa herë të njëjtët tituj. “Më e rrezikshme se censura ishte autocensura, ku vetë autorët e cungonin veprën e tyre, e sterilizonin atë”, - tha Lleshanaku. - “Arti zhvishej nga çdo formë kreative dhe njeriu bëhej të dukej sikur qe thjesht krah pune në socializëm”. Lleshanaku kujtoi gjithashtu se si arti u përdor për të ndëshkuar intelektualët që konsideroheshin si të rrezikshëm nga regjimi. “Cilët ishin këta intelektualë të rrezikshëm? Ata që mendohej se infektonin publikun me personalitet”, - tha Lleshanaku. Sipas saj, censura prekte edhe lexuesit, duke i lënë të painformuar.

Kineasti Kujtim Çashku preku disidencën, rezistencën dhe propagandën në kinematografinë shqiptare të viteve 1952-1992. Duke analizuar jetën dhe veprën e brezave të kineastëve të asaj kohe, ai reflektoi se nuk pati ndëshkime për arsye kinematografike të kineastët, por këto ndëshkime më tepër erdhën si pasojë e paranojës së regjimit. “Nuk do të thosha se kinematografia shqiptare në atë kohë pati disidentë”, - tha ai. - “Censurën mund ta gjejmë te procesverbalet e skenarëve të hequr të filmave”.

Piktori dhe arkitekti Maks Velo, ish-i persekutuar nga regjimi komunist, u shpreh se ndryshe nga shkrimi dhe piktura, censura e komunizmit dukej më pak te kinematografia. “Kinemaja ishte shumë e kontrolluar, sepse ishte produkt kolektiv”, - tha Velo, duke sqaruar për punët individuale, si shkrimi, ku censura vinte më e drejtpërdrejtë.

Kineasti Çashku e vazhdoi diskutimin e tij duke shtuar, megjithatë, se ka pasur rezistencë në kinemanë shqiptare gjatë komunizmit deri në njëfarë përqindjeje të vogël. “Tek filmi *Gjeneral Gramafoni*, aktori Viktor Gjika, edhe pse i angazhuar në një film propagandistik, ia doli të ngrinte pikëpyetje të caktuara mbi regjimin duke i bërë të dukeshin sikur i drejtoreshin pushtuesve në luftë”, - tha ai. - “Të vërteta shumë të mëdha janë thënë në filma nga personazhet negative duke folur me gjuhë të caktuar rezistence”. Duke vazhduar mendimin mbi vlerat që ka lënë arti vizual i asaj kohe, kineasti shpjegoi se ndikimi i propagandës u ka dhënë rëndësinë e dokumentimit të periudhës veprave kinematografike të asaj kohe, por nga aspekti artistik vlera e tyre qe e papërfillshme.

Profesori amerikan Bruce Williams, i fokusuar në historinë e kinematografisë, solli në takimin e së enjtes disa nuanca të censurës, me të cilat haseshin në po ato vite kineastët në Hollivud. Sipas Williams, Hollivudi kishte censurë duke përcaktuar gjërat që nuk duheshin bërë kategorikisht dhe nga ana tjetër, kodi i sjelljes në filma përcaktonte edhe gjërat për të cilat “duhej të tregohej kujdes”, si për shembull trajtimi i fesë, seksualitetit, figurës së rendit etj. “Kodi i sjelljes në filma lejoi vetëcensurën në kurriz të motorëve ekonomikë”, - sqaroi ai, duke shtuar se kineastët e kohës kufizoheshin duke iu përmbajtur rregullave me mendimin “le ta bëjmë këtë film që të shesë”.

Në mbyllje të takimit, piktori dhe arkitekti Maks Velo iu rikthye edhe një herë ballafaqimit me artin e asaj kohe. “Asnjë nuk kërkon falje. Ke dëgjuar ndonjë artist (që i ka shërbyer regjimit komunist) të kërkojë falje që bëmë gabim që lavdëruam Enver Hoxhën?” - pyeti ai retorikisht.

Çashku, megjithatë, e mbylli takimin duke u shprehur se regjimi dhe e shkuara duhet çmontuar përmes analizës së thellë dhe se rëndësi ka që e shkuara të mos kalojë në heshtje.

Reporter.al



KËNGË TË SOLOMONIT

Nga Sadik Bejko

KËNGË TË SOLOMONIT

1
Imja Sulamith
Shtriq krahët, pulit sytë
Shkund argjendin e vjetër
Të Këngës së Këngëve
Me këmbë të kërthinjta
Zbathur zbret shkrepat e Sionit
Shkel Detin e Vdekur të shkretëtirave
E brishtë si aroma e menteve të kodrave
E tmerrshme si një ushtri e armatosur
Shqyen copëzat e mermerëve të lashtë
Si zogjtë lëvozhgën e vezës
Dhe i gëzohet diellit
Ujit e barit, reve dhe majit.
Mirë se erdhe Sulamith
Që tre mijë vjet e sëmure
Nga një dashuri
Që përherë prej thelbit të gurit të ringjall
Si një pemë me gjethe
Si një ujkonjë që meshkujt gëlltit
I bën mollë për gjirin
I bën argjend për shkëmbinjtë
E detit në vreshtin e dallgëve
Dhe në gjumin e erës që nga hiçi
Rend me drenusha këmbëkërthinjtë.
Mirë se erdhe Sulamith,
Maleve dhe valtheve
Ujërave dhe zalleve.

2
Trëndafile e brishtë
Në hajatin e botëve hedhur.
Një shi bie e rrjedh bashkë me natën,
Dhe një vetmi e egër më zhvesh
Më bën shuall me hiçin.
Një trëndafile e brishtë e hedhur
Botës përkaj m'u duke sot, Sulamith.
Në barin ku jam, shiu lakohet butë
Mbi fletët e qelqeve, të gjetheve më tej.
Dritat e barit rrëmbushen
I veshin me lëkurë lotësh
Pikat që lëvaren nga strehët gjer në tokë.
Muzika mbush e ngjiz heshtjet,
Prek muret, gjethin e prillit në mure
Për t'i asgjësuar në çast të gjitha
Dhe mua dhe shiun dhe natën.
Ti, trëndafil e qiri bashkë vizatuar
Në natë, trëndafil e qiri që digjet.
Vizioni yt shumëzohet në qelqet
Në pikat e shiut, në muret.
Nesër, nesër Sulamith... sonte
Vetëm pikat e shiut rendin e rendin.
Çlodhu sonte në natën tënde
Si në krahët e mi. Sot larg, në skajin e fundmë
Të litarit të natës. Në skajin e litarëve të shiut.
Nesër, nesër... trëndafile e dritës, Sulamith.

3
Tani që nata ra, u iki me vrap
Dritave, vitrinave, kafeve
Të zhytem qoftë dhe në pus terri të trishtë.
Më verbohen sytë, më lëbyren
Llërat, supet, këmbët e tua më ngulen në sy
Si shpata të holla, të lëngështa, të zhveshura
Tërësi, ngrohtësi, avull dhe fildish.
Tani që nata ra u iki dritave.
Rend nëpër pjesën time lumturisht të vdekshme
Në prekje, në therje gjembash
Në shtratin ku trëndafilat
Në fildishin e hireve të tua
Veniten e japin shpirt,
E në lumin lëkurëhollë të kësaj nate
Lëvrijnë, lëbyren, zhyten.
Oh, sonte e dua terrin e ndezur
Me shpatat e diellit tënd të mishtë.

4
Kam lexuar sot
Afresket e apostujve të mureve bosh
Rravgimin e tyre me sandale rëre nëpër shkretëtirë
Me kripën pëlcitëse të gurit në sy
Me djersën e drurit në ballin e ndalur të një dite...
Tash që muzgu breroi hijet, ngjyrosi qiellin
Dhe si tempuj të fortë murgu, të përkulur tokës,
Vuri të banojnë drurët poshtë tij,
Tani, ku më je ti, Sulamith?
Dil, shfaqu ngjyrave, pa rënë në natë.
Lërmë të të shoh siç je, sa pa më vdekur sytë
Si një sandale shqyer nga rëra.
Fill i qiellitë drite e peme zgjohu, shkëlqë.
Nata e ligë do të rritë bashkë me grashinat,
Shpendra e rrodhe. Çohu, përveshi mëngët,
Pastro barëra kopshti, kthjello pasqyrën
Ku po kalbem nga një ajër i thyer, i therur.
Apostujt e mureve si urthet lëvarur në gjithësinë
Rrahur diellit,
Kësaj vere me mua thahen, vetëm thahen.

5
Kodrat, kedrat e amforat
E aromave në dherat e varrosura
Të mbret Solomonit zgjohen.
Armatorët, ja, e hodhën në det
Anijen flakë të re, me dru kedri të Libanit.
Në bash është fytyra jote,
Barku yt farkuar nga dielli te vela e hapur,
Trupi lakuriq verbon detin,
Det, lindur dhe ky nga barku i nënës sate.
Larë me lot nga sytë me thika të burrave,
Busti yt, gdhendur nga duart e ujërave,
Çan dallgët me thepat e gjireve.
Në direk varet këmisha ime,
Than djersët e trasha të dherave
Dhe dëliret në diellin e jodin e deteve



Udhës për në tempullin e shkëmbit
Ku nusja e rigjetur kthen verën e vjetër
Spërkat ajrin dhe shtratin e dhëndrit.

6
Mos kërko të më takosh përditë,
Druaj mos t'më takosh as pasnesër,
As pas një viti, a pas një shekulli.
Takomë kur të jesh vetvetja
Vetëm e për veten tënde
Pa kohë, pa hapësirë,
Pa asnjë prani tjetër mes nesh
Qoftë dhe sa një fije floku.

7
Me qumështin jasemin të shtatit tënd në buzë
Mos më duhet të vdes tani, Sulamith?
Të kam humbur dikur në grinë e ditëve,
Tani që të gjeta
Mos duhet të vdes në të çarën e dherave,
Në të kuqen ngjyrë vullkani të tërmeteve,
Mos duhet të vdes në trinën prej druri të vreshtave?
Aroma të marajit, të makthit, të mjaltit
Të dheut qiellor, të manaferrës, të frashërit...
Me kokën tënde mes dy krahëve të mi,
Me vithet e tua në gropëzat e trurit e të shtratit.
Me qumështin jasemin të shtatit tënd në buzë
Mos duhet të shtang në hop e ringjallje apokalipsi?
Në dashuri të gëzova, Sulamith,
Në dashuri më gëzove dhe ti,
Në gotën e verës me ngjyrën e kuqe të mbretit.

8
Sa e bukur, Sulamith... bukur e bukur
Për ty, për mua, për veten tënde,
Kështu më ishte sot, Sulamith.
Dhe që je plot hir të dua: që je kaq e bukur.
Për qejfin e vetes, të jetës dhe për qejfin tim
përherë t'më jesh bukur e bukur, Sulamith.
Vallë, jemi të përvetshëm? Të pandryshuar?
Mbetemi gur të ngulur si shkëmbinjtë në tokë?
Kështu bukur e bukur ti më je sikundër mbi dallgët,
Mbi retë, sikundër mbi yjet, mbi qiejt.
Në tokë zbret sa për të thënë: e shihni,
më shihni? Bukur e bukur jam. Lumtur
e lumtur jam. Vetëm në dashuri jam

Marrë nga libri me poezi "Këngë të Solomonit", 2017

Fragment nga romani i ri “15 ditë prilli”, botimet Çabej

ORA E ANATOMISË...

Nga Anisa Markarian

Të kapura për dore si vajza të vogla, Ida dhe Viku kishin marrë rrugën për në godinën e laboratorit të anatomisë. Ecnin me hap të ngeshëm. Ora e praktikës do të fillonte pas dyzet minutash. Të kritikuar për vonesën e djeshme, ishin zgjuar që në pikë të mëngjesit dhe kishin marrë autobusin e parë.

- Sa të presim përpara portës, a shkojmë pimë një kafe te bari? - propozoi Ida.

- Joo, nuk jam mirë. Kam frikë se do të nxjerr bark e zorë sot, - foli Viku, e zbehur në fytyrë. - Herën e fundit ndjeva një lloj të fikëti.

- Të shqetëson era e formalinës?

- Më përzihet kur shoh kufomat e shkalafitura. Fije-fije i kemi bërë...

E kishte fjalën për trupat e të vdekurve mbi të cilët ushtroheshin për të mësuar anatominë e përgjithshme. Kufomat e rrënuara nga autopsitë e panumërta zëvendësoheshin çdo tre muaj me trupa të rinj.

- A e ke pyetur ndonjëherë veten se nga vijnë ata të vdekur? - foli Ida nën zë.

- Njerëz që ia kanë dhuruar trupin shkencës, ma merr mendja.

- Kështu duhej të ishte, në fakt.

- Por...?! Nuk është kështu?!

- ...

- Me ty po flas. Sa misterioze bëhesh ndonjëherë! Ma ndeze kureshtjen.

- Mendohu pak, qetësisht, - e këshilloi Ida.

- Trupa të grabitur në varreza?! Të zhgroposur pa leje?!

- Ndonjë ide më të mirë?

- Një sekondë! Qenie bionike të prodhuara në laborator? Hahaha! - u dëfrye Viku.

- Joo, u largove shumë.

- Po më zbavit ky rebus. Dashka fantazi të zhvilluar.

- E gjen, e gjen! - i dha zemër Ida.

- Ëëhh... Trupa jashtëtokësorësh të rënë aksidentalisht nga anijet e tyre kozmike?!

- Fantazia jote po merr përmasa ndërgalaktike, e dashur, - e përgëzoi Ida.

Nuk patën kohë të flisnin më gjatë. Përballë tyre u shfaq profesori i anatomisë, i shoqëruar nga laborantja dhe asistenti. Ndryshe nga leksionet në amfiteatër, ku ishin të pranishëm të gjithë studentët e kursit, në orët e praktikave në laborator punohej me një numër të vogël pjesëmarrësish, për t'i dhënë mundësinë secilit prej tyre të shqyrtonte me imtësi çdo skutë e hulli të indeve e organeve. Ndërkohë që vishnin bluzat e bardha dhe merrnin në dorë tabakatë e vogla prej alumini me instrumentet prerëse, laborantja futi në sallë barelën me rrota, me anë të së cilës kryente zhvendosjet e të vdekurve nga dhoma e ftohtë drejt sallës së laboratorit e anasjelltas. Secili grup studentësh kishte të vdekurin e vet.

Profesori tërhoqi mushamanë e bardhë me të cilën qe mbuluar trupi dhe i ftoi t'i afroheshin tavolinës së mermertë ku praktikoheshin autopsitë. Vikut iu drodhën gjymtyrët. Nga frika se mund të rrëzohej, iu shtrëngua Idës pas krahut. Pamja e atij mullari mbeturinor e llahtarisi. Tre muaj më parë, ajo masë amorfe mishrash e kockash formonte një trup muskolor mashkulli që dukej sikur flinte. Lëkura e tendosur, mollëzat e kërcyera dhe dhëmbët e shëndetshëm dëshmonin se ishte moshatar me ta. Në vetëm pak javë, shakullina e disektiveve e kishte shndërruar në një cofëtinë të paemërtueshme. I gjallë nuk ishte më, sigurisht. Por as i vdekur. I përkiste një kategorie më vete: “material njerëzor në shërbim të mjekësisë”. Lëndë studimore e ruajtur në formalinë. Kush, vallë, e kishte bërë përzgjedhjen e trishtë? Në ç’instancë të lartë a të nëndheshme ishte marrë vendimi?

Të përbrendshmet e mashkullit mungonin. Ia kishin shqitur disa javë më parë. Brenda zgavrës i vareshin zhelet e dhjamërave të nënbarkut. Muskujt ishin të grisur lapra-lapra. Të ekspozuara mbi kafazin e krahavorit si mbi një banak ankandi, arteriet e venat formonin një rrjetëzim parzmak. Ida nuk e mbante mend me saktësi si kishin qenë tiparet e fytyrës së paprekur të djaloshtit. Pamja e tanishme nuk mund ta ndihmonte kurrësi t'i rikujtohej. S'ishte veçse një maskë e rrjepur tërthorazi që shërbente si kapak për nënshtrojtat indore. Kokërdhokun e syrit të majtë - të djathtin ia kishin gërryer dy javë më parë - e kishte të zgërlaqur. Lëkura e shpërvjelur e kokës nxirrte në pah cipat dhe eshtrat e kafkës: ashtin guaskor të ballit, pllakaqet kockore murore, ashtin zverkor si guall breshke me vrimën rrumbullakore në qendër, ashtin pykor në formë lakuriqi nate, ashtin shoshor tehbrisk e oda-oda, kockat tëmtore petashuqe nga njëra e tjetra anë e kokës. E majta kishte një parregullsi të vogël. Ishte e shpuar në një cep nga një birë e zezë qorre.

- Përderisa nuk ka vrimë daljeje, do të thotë se plumbi ka ngecur në tru, - tha Ida, sikur po fliste me veten.

- Të lutem... - iu përgjërue Viku dhe ia nguli thonjtë në llërë për t'i lënë të kuptonte dhimbjen që ndiente.

- Javën tjetër do të studiojmë sistemin nervor qendror, - njoftoi profesori i anatomisë. - Do ta fillojmë me organizimin e përgjithshëm të trurit, cipat mbështjellëse, hemisferat, lobet... Mos harro frezën për hapjen e kafkës, - porositi laboranten.



U dëgjua një klithje e mbytur si një shungullimë dështake. Gojën rrethuar me njëren dorë e tjetrën shtrënguar në lukth të stomakut, Viku lemozonte me gulçe e palosur më dysh.

- A mund ta shoqëroj jashtë sallës, profesor? - pyeti Ida.

- Po, po!

- Merr frymë me hundë, thellë e shpejt, pastaj bëj një pauzë të vogël e nxirre ajrin nga goja sa më ngadalë, - e udhëzoi kur kishin dalë në oborrin e godinës.

- E dija që do të villja, - u ankua Viku.

- Jo, jo, po ngatërro lemmën me të vjellën, - iu përgjigj Ida që i fërkonte supet dhe shpinën për t'i lehtësuar sikletin. - Ja, u qetësove. E shikon?

- Më bëri mirë ajri i freskët, - pëshpëriti ajo. - Eja pranë meje.

Ida u ul në gjunjë përballë saj e ia mori duart në të vetat me dhembshuri.

- Sa hutaqe jam ndonjëherë! - qortoi veten Viku. - S'e kisha vënë re vrimën në tëmtë.

- Mos e mendo më atë punë. Të paktën jo tani.

- E pamundur ta heq nga mendja... O Perëndi! Të mjerat nëna që presin t'u kthehen bijtë, - pëshpëriti zëdrithur.

- Munda të marr vesh se si arrijnë në fakultet, - foli Ida. - Ma tha roja i morgut. Kur është i pirë, shet nënë e babë... I sjellin me një kamion ushtarak të mbyllur në arka metalike. Herë janë dhjetë-dymbëdhjetë trupa, herë më pak. Varet nga “furnizimi”.

- Furnizim makabër...

- Ndoshta janë rekrutë dezertorë. Po ta shohësh me kujdes, që të gjithë janë të qethur njëloj: zverku i rruar “zero” dhe gjatësia e flokëve mbi tepelek jo më shumë se një centimetër.

- Ti ke gabuar profesion, - nënqeshi Viku. - Duhej të ishe bërë gazetar ose detektive.

- Kur të na sjellin trupat e rinj, do të mundohem t'i fotoj, - i rrëfeu Ida.

- E për ç'arsye? Që të mos harrosh si i kishin fytyrat përpara se t'i shkalaveshim?!

- Aspak.

- Përse, atëherë?!

- Duhet dokumentuar kërdia.

- Ti je e çmendur! Më dëgjove?

- Asnjëri prej tyre nuk ka vdekur në mënyrë natyrore, - vazhdoi Ida. - Është fare e qartë që i kanë ekzekutuar... Ti, në vendin tim, do të heshtje? - e pyeti duke e zhbiruar drejt në sy.

- Jo vetëm e çmendur, por edhe naive... - pëshpëriti Viku si të fliste me veten. - Je aq naive, saqë po më fërgëllojnë mishtë nga meraku për ty.

- Do t'ia tregoj Leksit fotot. Ndoshta njeh ndonjërin prej tyre.

- Që ta marrësh më qafë edhe atë?!

- Jo. Që të më ndihmojë të gjej familjet.

- Kokëmushkë!



Historia e përkthimit për herë të parë të “Pinoku”-t në shqip, përkthyer nga Cuk Simoni në vitet ‘30, botues i “Cirkës”. “Nji revistë me vlera qytetare e cila krijoi një hulli kulture ndryshe prej simotrave tjera dhe me ambëlsi e dashuni s’prani së latuemi gjuhën shqipe tue mbetë edhe sot ndër gurët e çmueshëm të historisë së publicistikës sonë”, - shkruan Adrian Ndreca duke na njohur me përkthimin e Simonit, me parathënie prej tij, e me ilustrime të botimit të parë nga Terezina Simoni Shiroka

NGA BARI NË SHQIPËRI, SI ERDHI “PINOKU” NË SHQIP

Nga Cuk Simoni

Ndodhshe në Bari e në mrame do t’u nisëshe për Shqypni. Mbasi qyshë paradite i kishe krye të gjitha punët e mija, tuj mos pasë se çka me ba, xuna me u endë nëpër rrugët ma të parat e gjytetit, tuj u ndalë me shikjue ndër xhama të tregtoreset.

Kur para njanes ndër këto tregtoreset më ndodhë diçka qi nuk e pritëshëm. Un po shikojshe n’at xham nji fmi nja i gjysë metri giatë, me nji ksulë me majuc në krye; me nji gjaketë të shkurtë prej kah delshin dy krahë... druje; me nji palë panta-llona, ku rrishin krejt lireshëm dy kambë të holla ke s’ve, edhe ato... druje. Nji hundë, mandej, giatë, me thanë, një pllammë...! Fundi i punës, Pinoku vetë!

Kambë e krye! Ndeja tuj e shikjue me ande, kah më çoi mallin e fmnis. M’u duk si me nde-shë në nji ftyrë të njoftun kahmot, në nji fmi të dashtun. Së mramit deshta me kalue. Por kur ishem tuj u largue, m’u duk se po më shikjon edhe aj mue e bile se po më lot synin. E vë oroe dhe ma mirë e po shof se po ban buzën në gaz e po më ban me krye si me dashtë me thanë: “Eja mrendë.” Un ma nuk u mata aspak, por çila derën e tregtores e hina mrendë.

- M’a fal t’a shof njat buratin qi keni qitë në xham, - i thaçë shegertit qi më duel para. Me të shpejtë ky e hoq prej xhamit e m’a dha në dorë.

Un e mora e pshteta mbi banak.

Pinoku më shikjoi edhe nji herë, qeshi prap e mandej, pa ba as nji as dy, po kacaviret për mue tuj u kapë me njanën dorë për kravate e me tjetrën per hundë e tuj m’a avitë gojën te veshi po më thotë me za t’ultë:

- Due me ardhë me ty në Shqypni!

- Me mue?!

- Po, po, due me ardhë! - i a bani prap, tuj i shkrepë

ato kambë druje për banak e tuj ia nisë vajit.

Nuk e çova ma giatë, tuj mos dashtë me ba poetere n’at tregtoreset. Pagova paret e dola me Pinok nën krah.

- E ke gabim, more Pinok, - xuna me i thanë mandej rrugës, - ti nuk ke pse vjen në Shqypni, kanë për të marrë për lojë, nuk kanë me të kuptue e nuk kanë me të dashtë.

- Jo, jo e ke gabim ti! Çka dini ju të mdhajt me marrë vesht fmijt? Na dijm me marrë vesht shoqishojnë. M’a len mue ti! Unë kam përshekue mbarë botën, - vijoi mandej, - e gjithkund më kanë pritë me krahë hapët. Shqypnija vetëm më ka mbetë pa e pa: due me ba miksi edhe me shqyptarët e vogjël.

- Po mirë, po kush t’a mson ty giuhën qi m’u marrë vesht me fmi shqyptarë? - i thaçë.

- Ti! - m’a priti aj me të shpejtë.

- Un?!...

- Ti po, pse po çuditesh?

- Un nuk mundem, - i tham, - pse un nuk jam i degës; un nuk jam msues.


- Ti, ti do të m’a msjosh shqypen!

Si Pinoku ma! I ishte ngulë mendja ashtu e s’ishte punë me luejtë. Prandej nuk i bana ma za tuj mendue se si t’a kishem shti në Shqypni, kishem për t’i a porositë e dorëzue ndokuej qi merret me këso punësh.

Kështu mendoshe vete, por... s’mendote kështu Pinoku. Ishim dy mendimesh. Si njerzt e mdhaj!

E njimend, kur u ketheva në vend t’em e dhaçë e mora për sa dit me i a mbushe mendën me hi në dorë të tjerve, s’kje send me ndigie, por dote doemos qi të i a msoj shqypen un.

Çka me ba!



Un qyshë kur e dojshe fort Pinokun e nuk më bate zemra me e lanë në njanë anë.

E mbasi dashtnija asht e fuqishme, ma e fuqishme se fuqija vetë, m’u desht doemos me i a çue dishirin në vend.

A don at herë me hi e me ia msue giuhën... vedit. Pse mendoshe se giuha qi dij vetë nuk mund të bajë për Pinokun, mbasi për te lypet nji giuhë e goditun, e hollueme, lypet giuha letrare. Bleva gramatikë, fjaluer e libra leximi e u vuna me xanë si t’ishem njitë në shkollë.

Mbas nji kohe mjaft të giatë, m’u mbush mendja se ishe pjekë për me i u ba msues Pinokut. Edhe hoqa ç’ka hoqa, në fund desht Zoti e me duel me i a shti në krye çka paçë xanë vetë.

Ishin mbledhë nji ditë n’oborr të shpis disa fmi e po luejshin s’dij se ç’farë lojet.

- Shko edhe ti poshtë, - i tham Pinokut, - shko e luej edhe ti me ta n’oborr.

Ngurroi nji herë, më kqyri mue, kqyri fmijt tuj luejtë, e mandej kapi derën, për shkallash e fill e në mes të tyne. Ata lanë me nji herë lojën tuj e rrethue të gjith Pinokun, si t’ishte shoku kahmot i pritun. Dikush i thotë nji fjalë, dikush nji tjetër, por po shof prej dritësorës se Pinoku po i hapë syt si nji nieri qi nuk kupton. Diçka flet edhe aj, por duket se tjerët nuk po e marrin vesht. Në fund Pinoku shgrehet në vajë: njitet nalt e, tuj fërkue syt me gishta, më thotë:

- Un nuk merrem vesht me ta! Ç’farë giuhet më ke msue ti?

- Mundë, - bjerrti vetë, po tash si me i a ba?

- Me më msue giuhën e atyne fëmijve! - m’a priti aj.

- Po mirë veç, - e thaçë me vedi: - Mbasi i hypa këtij kali, më duhet domosdo me e ndigie.

E mbasi e pash se në giuhë letrare nuk kishëm xanë gja, hina më i a msue giuhën qi flitëshëm.


Ky msim i dytë nuk m’erdh i vshtirë e për pak dit mund t’a krevu.

Si u mblodhën prap nji ditë tjetër ata fmi n’oborr e bana Pinokun me ta, e un ndeja pas si në njanë anë për me pa si shkon puna.

U miksue me nji herë me të gjith! Pinoku fol e ata qesh, Pinoku ban laradsha e ata shpërtheju në gaz, Pinoku nga e ata mrapa! Kur, pa u kujtue askush, kapi derën e oborrit, duel jashtë e u lshue në pikë të vrapit.

- Kapnie, kapnie, pse ka petkat e shkyeme! - u bërtas atyne fmijvet.

- Po... hec e kape!...



Studiuesi i letërsisë Đorđe Krajišnik ka botuar në faqet e gazetës serbe “Oslobođenje” një vështrim kritik mbi librin me tregime “Shpina e burrit” të Arian Lekës, botuar në Beograd në fund të vitit 2018 nga “Partizanska knjiga”.

Hapësirë me plasaritje të imta

(mbi vëllimin me tregime “Shpina e burrit” e Arian Lekës, botuar në Serbi)

Nga Đorđe Krajišnik

Letërsia shqiptare për ne, në hapësirën post-jugosllave, mbetet ende një e panjohur e madhe. Marrëdhënia me këtë letërsi dhe autorët e saj ka qenë dhe mbetet e penguar nga barriera të llojllojshme politike, por edhe nga mosinteresim ynë absolut për të kuptuar kompleksitetin e jetës në këtë vend dhe orientimin kah kultura e tij. Qëndrimi i përgjithshëm i derisotëm ndaj kulturës shqiptare përbën një lloj marrie raciste, që vjen para së gjithash nga largësia gjuhësore, e reflektuar me dekada në letërsi, andaj tek ne kanë mbërritur pak materiale, që të mund të zbulojnë atë çka pikërisht letërsia e një vendi në një farë mënyre të afërt për ne, nga fenomene të këtilla, të jetë kaq larg nesh.

Avangardë letrare

Në të shkuarën lexuesit në gjuhën serbe kanë pasur rastin të njohin letërsinë shqiptare para së gjithash përmes përkthimit të klasikut të kësaj letërsie, Ismail Kadare. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” ka mbetur pwr ne një nga krijimet më të njohura, që vjen nga kjo pjesë e botës.

Kompleksiteti i pozicionit politik të Kadaresë, jeta e tij parisiane dhe gjithçka që ajo ka sjellë me vete, e kanë bërë atë ndër të rrallët autorë, që kanë mundur të përcjellin diçka nga bota e mbyllur e regjimit të Hoxhës. Në kohët e sotme kësaj mund t’i shtojmë edhe disa përkthime të autorëve kosovarë si Veton Surroi apo poetit Arben Idrizi, pa lënë jashtë përmendjes dramaturgët Doruntina Basha dhe Jeton Nezir, tekstet e të cilëve janë interpretuar në disa prodhime teatrore rajonale. Ndonëse bëhet fjalë për krijime letrare, që në shumëçka i kapërcejnë kornizat lokale, ato gjithsesi nuk kanë ngjallur ndonjë interesim të gjerë në hapësirat tona. Libri me tregime “Shpina e burrit” i shkrimtarit Arian Leka, botuar nga “Partizanska Knjiga”, është përjashtimisht një krijim me vlerë dhe i rëndësishëm për të kuptuar atë çka sot letërsia shqiptare përfaqëson. Arian Leka është një autor, që në kontekstin europian, u bë i njohur pas hapjes së Shqipërisë dhe përfaqëson avangardën letrare, e cila ka për ushqim dominant shartimin e veprimit soc-realist të kohës së Hoxhës. Ajo çka lë vrragë të qenësishme në kontekstin e të kuptuarit të këtij libri është fakti që kultura shqiptare në kohën e Enver Hoxhës ishte pothuaj tërësisht e izoluar. Në aspektin letrar, kjo gjente pasqyrim para së gjithash në kontrollin e rreptë të asaj që krijohej dhe botohej, çka prodhonte një kontekst specifik për zhvillimin e letërsisë e cila, në të çarat e sistemit, rendte e frikësuar drejt mundësive të ndonjë shprehjeje tjetër. Leka, si shkrimtar, gjykuar nga mënyra e ndërtimit të tregimeve, e ka përdorur padyshim si ushqim të parë letërsinë soc-realiste. Mirëpo si autor, ai e shpërfill atë dhe dyshtetë e saj e ka shfrytëzuar për të zhvilluar stilin e rrëfimit i cili, jam i lirë ta them, sot përbën një nga markat më autentike autoriale në këtë pjesë të Evropës. Ajo çka përmbledhtazi mund të merret si veçori bazë e tregimeve të Arian Lekës ndoshta gjendet në një fjalë të tregimit të tij “Terra Firma”: “Gjithçka arriti kulmin. Fabula nuk zhvillohej dot më tej, ndaj duhej bërë

gërshet. Përdora teknika postmoderne-metafiksionin, pastisin, fiksionin dokumentar, shfrytëzova paranojën kolektive dhe euforinë e masave, futa edhe diçka nga realizmi magjik dhe...” Përgjatë gjithë librit “Shpina e burrit” do të gjendet e alternuar formula e pikturimit të botës në prozë. Në këto tregime Leka sillet pandërprerë me regjistër të ndryshuar, eksperimenton me veprimin dhe gjuhën, duke i shpënë shpesh heronjtë e vet në situata krejtësisht absurde. Të çudit, qoftë edhe në trajtën përkthimore, siguria me të cilën ky krijues zbrërthen disa nga ngjarjet më traumatike të së shkuarës shqiptare dhe të sotmes, por edhe invencioni letrar që Leka servir në trajtimin e temave. Shpina e burrit na tregon padyshueshmërisht se Arian Leka është një autor ndërmjetësues, që e kapërcen dukshëm një kulturë të vetme, autor që me talentin dhe vrullin e vet hyn në radhën e mjeshtërave të mëdhenj të kohës sonë. Nëse do të flitim për konturin tematik të këtij libri të Arian Lekës do të mund të përmendnim tre linja përmbajtimore që gërshetohen. Njëra syresh, e ngulitur thellë në Shqipërinë e post-Hoxhës, është pikërisht përplasja mes brezave, ndeshje që vjen pashmangshmërisht pas ndërrimit të një sistemi me një tjetër. Kjo temë gjithsesi është deri diku familjare për lexuesit e hapësirës së Jugosllavisë së dikurshme, vetëm se Leka atë raport e ekzaminon mjeshtërisht në një sërë tregimesh. Autori merret para së gjithash me traumën e atyre që kanë përjetuar torturën e diktaturës së Hoxhës, por edhe të atyre, që të ndodhur nën trysni, lanë vendin. Sindromi i arratisë, i shpërnguljes dhe zbrazjes së Shqipërisë, në një numër tregimesh, shndërrohet në temë që sundon fatin e tyre. Leka megjithatë nuk thurr tirada të angazhuara, nuk politizon. Ai gjurmon në këto hapësira më shumë dromca të së vërtetës dhe prej këtej tregimet e tij

hyjnë në një hapësirë me plasaritje të imta, prej të cilave më pas del në honet e konvulsioneve universale njerëzore përballë mundimeve ekzistenciale. Edhe pse përkthimi i një libri të vetëm nuk do të thotë zbulim i një letërsie të tërë, gjithsesi pa “Shpinën e burrit” do të kishim mbetur ende sot, padiskutueshmërisht, më të varfër nga një zë i fuqishëm tregimtar.

Zbrazja e vendit


Tema e zbrazjes së vendit pas diktaturës mbetet në këtë kontekst interesimi më i fuqishëm artikulluar nga Leka. Tregimi “Gjilpërat në kokë”, për shembull, na rrëfen qartësisht përmasat e katastrofës së një shoqërie të mbytur në vite me dhunë. “Na kishte ardhur radha që edhe ne të ishim nga pak hebrenj. Gjithkujt, herët apo vonë, ka për t’i ardhur radha. Do të ndodhë... Në të vërtetë nuk ka pasur asgjë të shenjtë, por as edhe biblike në eksodin e shqiptarëve në fund të shekullit XX.” Ngjashëm Arian Leka do të trajtojë problemin e largimit edhe në tregimin “Lulet në ballkonin e tjetrit”, ku heroi përshkon si fantazmë ambientet e zbrazura të të njohurve, që kishin ikur brenda natës, ndërsa në tregimin Pema, në një dialog mjeshtëror dhe përmes dëshmimeve të dhunimit të të miturit do të çohet në kulm përplasja komplekse e brezave dhe manifestimi i racizmit ndaj atyre që mbeteshin rrugëve të Evropës. Temë e dytë e rëndësishme e librit “Shpina e burrit” mbetet tematika e familjes. Kuadri social-politik i përshkruar do të reflektohej edhe në raportet brenda familjes. Në këto tregime Arian Leka arrin pikën më të lartë. Problemi i përplasjes në një familje tradicionale, bazuar në jetën fisnore dhe me norma të ngurta, me mbërritjen e kohëve të reja, flladit perëndimor, detyrimisht do të sillte ndryshime në strukturën e shoqërisë shqiptare, çka Leka e jep me sugjection dhe saktësi prej mjeshtri.

Në tregimin Zogjtë e pikturave, skena ku babai, kryefamiljari, shfaqet cullak para trashëgimtarëve, përbën një kulm rrëfimtar, i cili shtresëzon thellë një siklet që ndryshoi me themel marrëdhëniet brenda familjes. Kemi përnjëmend të bejmë me një metaforë të mrekullueshme të frikës familjare që mban larg njerëz, që duhej të ishin më të afërtit.

Arian Leka në këtë tregim, sikundër edhe në tregimin e arrirë Brisku (i cili të kujton disi tonin e rrëfimit të Čamil Sijarić), tregon shembjen e familjes tradicionale dhe dhimbjeve që e pasojnë. Nga ana tjetër, çështja e dasmës dhe dashurisë, robërimit prej tyre në ato kushte sociale që ekzistonin, në tregimin me titullin e vëllimit Shpina e burrit, i ofron lexuesit kujtesë elegante për atmosferën dhe detajet. Linja e tretë tematike që haset në tregimet e Arian Lekës ka të bëjë me eksperimentet letrare postmoderne. Ka plot shembuj në këtë vëllim, ku Leka orvatet të shpërthejë kornizat e tregimit klasik, duke hyrë në eskapada tekstore, të cilat janë tekanjoze dhe presin në besë logjikën e tregimit. Gjithsesi ajo që shihet nga një manovër e tillë është që ky shkrimtar me një gjuhë të tillë mëton të gjejë hapësirë për ironi efektive, qoftë të pozicionit të vetë shkrimtarit, qoftë edhe të veprimit të dezintegritimit të tregimit. Më mirë se kudo gjetkë, kjo demonstron në tregimet Sekreti i jetëgjatësisë dhe Ftesa. Ndërsa veprimi postmodern në tregimin Krijim i Njeriut të Ri shfrytëzohet me synimin për të shpënë në absurditet çmendurinë nacionaliste të etnoinxhinjerimit dhe mitomanisë. Arian Leka është autori që na ndriçon madhërisht kontekstin e letërsisë shqiptare. Ndonëse përkthimi i një libri të vetëm nuk do të thotë zbulim i gjithë letërsisë, gjithsesi, e nënvijëzoj, pa librin *Shpina e burrit* do të kishim mbetur sot e gjithë ditën, padyshueshmërisht, më të varfër nga një zë të fuqishëm tregimtar, i cili, në një formë a në një tjetër, me siguri na përket të gjithëve ne.

Përktheu nga origjinali Astrit Begiraj

*Oslobođenje është një nga gazetat e përditshme më të vjetra në rajon dhe më të rëndësishme në Ballkan



VIKENA KAMENICA AZUCENA, CIGANIA TRAGJIKE E VERDIT

Ulërin flaka

Turma e trazuar

Ngarend drejt zjarrit

Me fytyra t'lumtura,

Thirrma gëzimi

Jehojnë përreth,

Rrethuar nga vrasës

Një grua sillet përpara!

Vargjet e aries së famshme “Stride la Vampa”, në aktin e dytë të operës “Il Trovatore” e bënë publikun të kuptojë peshën që kompozitori italian i dha Azucena-s, ciganes së etur për hakmarrje. Zjarri i ndërmend të ëmën, të djegur në turrën e druve nga konti i vjetër Di Luna.

Në shpatet e malit të Biskajës bubulon zjarri i madh. “Kujtimi i lemerishëm më përndjek, - vajton Azucena e çmendur për hakmarrje, - e bën gjakun tim të rrjedhë i ftohtë”. Pranë i rri Manrico-ja, i mbështjellë me mantelin e tij. Ka helmetën mes këmbëve dhe mes duarve shpatën, mbi të cilën ngul vështrimin. Por, ndërsa rapsodi Manrico është heroi romantik i veprës, është pikërisht Azucena që e shtyn veprimin përpara. Giuseppe Verdi fillimisht mendoi ta titullonte operën “Cigania”, por mbajti titullin e dramës, në të

cilën u bazua edhe opera “Il Trovatore”, që në shqip do të përkthehej “Rapsodi”. Ciganët fushojnë, ndërsa Azucena i rrëfen Manrico-s se pasi pati rrëmbyer foshnjën Di Luna, pati qëllim të digjte të voglin bashkë me nënën e tij, por, e tronditur nga thirrmat dhe skena e llahtarshme e ekzekutimit të së ëmës, u hutua dhe hodhi në flakë foshnjën e saj.

Ulërin flaka!

Viktima mbërrin

Veshur në të zeza,

Shprishur, këmbëzbathur!

Një britmë e paepur

E vdekjes ngrihet,

Jehona përsërit

Nga kodra në kodër!

Me flokë të shprishur e të thinjur, Vikena Kamenica ka hyrë në petkat e ciganes. Sipas mexosopranos, të interpretosh emocionet që Verdi ka vendosur tek Azucena, “është mirë ta kesh jetuar peshën e nënës në kockat e tua, në shpirtin tënd”. Do të ishte mëkat të mos përcillej ai lloj emocion, rrëfen Kamenica, së cilës regjisorin italian Mariano Bauduin i ka besuar rolin.

Me një skenografi bardhezi, si një enigmë shahu,

opera “Il Trovatore” e mblodhi publikun kryeqytetas në sallën e Pallatit të Kongreseve për tri net, ndërsa 11 maji ishte nata e fundit e shfaqjes që ngjiti në skenë një kastë të përzier artistësh shqiptarë, italianë, serbë, ukrainas dhe gjeorgjianë, nën dirigjimin e një tjetër italian, Sebastiano Rolli.

“Në impostimin e parë të veprës, normalisht që më ka dhënë një gjendje jo të mirë emocionale, sepse ishte nga dimensionet më drithëruese. Të qenët nënë dhe të kaluarit dramë të këtij lloji, të kaluarit një dramë me një forcë mbinjerëzore, vetëshkatërruese, normalisht që nuk ka dhënë një lloj qetësie në punë e sipër”, - do të shprehej Kamenica, e cila e sheh interpretimin e Azucena-s si një piskamë të shpirtit. Për t’ia dalë, do të shtonte mexosopranoja, duhet të bësh arkitekten e muzikës me interpretimin.

Historia nis të rrëfëhet që në aktin e parë, megjithëse në katër aktet ka elemente befasuese që e mbajnë publikun të ngërthyer mes emocioneve. Ferrando-ja, kapiteni i rojave, u jep urdhër të tijve të vazhdojnë vëzhgimin, ndërsa konti Di Luna bredh pareshtur nën dritaret e Leonora-s, e cila interpretohet nga sopranoja Eva Golemi e që me “Il Trovatore-n” plotëson trekëndëshin tragjik verdian, së bashku me “Rigoletto-n” dhe “Traviata-n”. Di Luna e dashuron Leonora-n dhe është xheloz për rivalin e tij të suksesshëm, rapsodin e panjohur. Që t’i mbajë rojat zgjuar, Ferrando-ja rrëfen historinë e kontit, ndërsa këndon: “Me dy bij jetonte ati i bekuar...”

Shumë vjet më parë, një cigane u akuzua padrejtësisht se i kishte bërë magji më të voglit të fëmijëve të Di Luna-s. Fëmija u sëmur dhe për këtë cigania ishte djegur e gjallë si një shtrigë, duke e shpërfillur pretendimin e saj për pafajësi. Ndërsa vdiste, ajo i la amanet së bijës, Azucena-s, të hakmerrej për të. Azucena e bëri duke rrëmbyer foshnjën. Megjithëse eshtrat e djegura të një fëmije u gjetën në hirin e një zjarri, babai refuzoi të besonte se i biri kishte vdekur. Ndërsa vdiste, babai i la amanet të parëlindurit, të riut kontit Di Luna, të kërkonte Azucena-n.

“Notat e Verdit janë vendosur në formën më të jashtëzakonshme, më të bukur dhe më emocionuese”, - ka rrëfyer Kamenica, ndërsa në karrierën e saj ky është një rol edhe më i thellë dhe me më shumë peshë që i shtohet repertorit të saj. - “Nuk bën lajm partitura muzikore, por emocionet që arrin të përcjellësh në këtë vepër”.

Bazuar në dramën “El Trovador” të vitit 1836, shkruar nga Garcia Gutierrez dhe me libret nga Salvadore Cammarano, opera e pati premierën në teatrin “Apollo” të Romës më 1853. Nuk ishte sukses i menjëhershëm kritik, por subjekti jotradicional dhe i veçantë e bëri tejet popullor për audiencat kontemporane.

Nga e majta, baritoni Gocha Abudlaze, sopranoja Eva Golemi dhe tenori Dario di Vietra.

Regjisorin italian që e solli në Tiranë operën, ka rrëfyer konceptin e tij për të ndërtuar një spektakël abstrakt. “Edhe pse ky abstragim ndjek logjikisht rrëfimin, ngjarja e një opere që ekstremisht e rafinuar në aspektin dramatik dhe muzikor. Dhe për këtë u jam referuar disa traditave në disa rajone të Italisë, një lloj vallëzimi me vdekjen që rrëfen rrjedhën e jetës dhe fatit”, - ka zbuluar Bauduin.

Tragjedia i ofroi Verdi-t kthesa dramatike dhe personazhe të forta që i pasuroi me arie të fuqishme dhe skena korale. Se si dhe kur Verdi e siguroi një kopje të dramës së Gutierrez-it nuk është e sigurt, por mendohet se Giuseppina Strepponi, me të cilën Verdi bashkëjetonte në Busseto që prej shtatorit të vitit 1849, kishte përkthyer dramën, ndërsa dëshmohet në një letër që ajo i shkroi kompozitorit dy javë para premierës, duke e nxitur: “Nxito dhe na jep *Trovatoren* tonë!”

Për ta përshtatur dramën, Verdi iu drejtua Cammarano-s si “poeti i lindur operistik”. Në letërën e parë drejtuar Cammarano-s, Verdi propozoi që *Trovatore* të kishte si subjekt dy role femërore. E para, cigania, një





grua me një karakter të pazakontë, sipas së cilës deshi edhe ta titullonte operën. Sfondi historik është lufta civile e Spanjës, ndërsa filli i operës është trekëndëshi i dashurisë. Konti, i interpretuar natën e parë nga baritoni Gocha Abudlaze, i vardiset Leonora-s, aristokrates e cila dashuron Manrico-n, udhëheqësin rebel.

Konti e sfidon Manrico-n në duel, por Manrico-ja nuk mundet ta vrasë kontin, pavarësisht se është në avantazh. Pastaj, në një kthesë të befasishme të subjektit, zbulohet se Azucena është e ëma e Manrico-s. Ose të paktën ashtu mendon ai, ndërsa zbulohet se është vëllai i vogël i kontit, që pandehej i vdekur. Manrico-ja, interpretuar nga tenori Dario di Vietra, kupton se nuk është i biri i Azucena-s, por e do atë si të ishte vërtet e ëma, pasi ajo kishte qenë e dashur dhe besnike me të, duke i shpëtuar jetën së fundi, ku pas një pusie e lanë në fushëbetejë për të vdekur. Duke menduar se i dashuri i saj Manrico kishte vdekur, Leonora hyn në Manastir, por, ndërsa ajo dhe murgeshat janë në procesion, Manrico-ja shfaqet duke e marrë me vete dhe për një herë të dytë e lë të palënuar kontin.

Azucena, cigania që hakmerret për djegien e së ëmës me një kosto të rëndë shpirtërore. Burgosja e Azucena-s bëhet arma e kontit Di Luna për ta mposhtur rivalin e tij në luftë e në dashuri. Në aktin e fundit, “Ndëshkimi”, tragjedia shpaloset me të gjithë fuqinë. Për të shpëtuar të dashurin, Leonora premtion të martohet me kontin, por, për të mos e tradhtuar Manrico-n, e ëmbla Leonora zgjedh të helmohet. Ndërsa dëgjon fjalët e dashurisë së tij të pamundur, vendos ta ekzekutojë Manrico-n dhe ciganen, mendja e së cilës breddh maleve në ditët e lumtura, tek këndon: “Maleve do të kthehem!”

“Mbaroi”, - thërret Di Luna kur ekzekutuesi ka vrrarë Manrico-n.

“Viktima ishte vëllai yt”, - vikat cigania shtrigë. - “Haku yt u mor, o nënë!”

“Dhe unë jetoj ende”, - thotë konti.

“Njerëzit thonë se opera është shumë e trishtë dhe ka shumë vdekje, por jeta, në fund të fundit, sillet e gjitha rreth vdekjes”, - do të shprehej dikur Giuseppe Verdi, ndërsa vargjet e aries së famshme “Stride la Vampa”, që në shqip do të përkthehej “Ulërin flaka”, jehojnë ende dhe kanë fuqinë të mbërthejnë publikun e shekullit XXI...

E liga shndrit

Mbi fytyrat e tmerrshme

Pranë flakës së vverët

Që ngrihet drejt qiellit!

Përgatiti S. B

KULTURË

SHQIPËRIA E VITEVE 1928-1931 NË ARKIVIN E DY DIPLOMATËVE ITALIANË

- Ekspozita “Arkivi fotografik i Pietro dhe Larissa Quaroni-t, – Shqipëria 1928-1931” Fotografitë janë realizuar nga çifti Quaroni gjatë misionit të tyre diplomatik në ambasadën italiane në Shqipëri. Të pabotuara më parë, 86 fotografitë i përkasin periudhës 1928-1931, shoqëruar nga dy dokumentarë të asaj periudhe.

Duke pozuar me kostum kombëtar shqiptar, çifti Pietro dhe Larissa Quaroni ndërtojnë një histori të tyre personale, të tërhequr nga kultura dhe foklori ynë. Kjo ishte koha kur ata vizituan Shqipërinë duke pasur kuriozitetin të arkivonin diçka nga kjo memorie, siç ishte pasioni për fotografinë. Me këtë ndërtuan një arkiv, duke sjellë në Tiranë një nga periudhat me interesante të vendit. Është Instituti Italian që kujdeset për këtë ekspozitë, që i takojnë pothuaj 100 viteve më parë, e cila hapet në Qendrën për Hapje dhe Dialog nga 14 maj deri 29 qershor. Është pjesë e koleksionit të arkivit personal fotografik të Pietro dhe Larissa Quaroni-t që janë bërë gjatë misionit të tyre diplomatik në Ambasadën e Italisë në Shqipëri në periudhën 1928 – 1931 dhe pjesa më e madhe e tyre ekspozohet për herë të parë për publikun. Në ekspozitë do të shfaqen përrth 85 fotografi të përmasave të ndryshme, të shoqëruara nga dy dokumentarë të të njëjtës periudhë dhe për herë të parë jepet mundësia të shihet në tërësinë e tij arkivi i pasur (mbi 750 fotografi) i digjitalizuar për këtë rast.

Duke patur parasysh rëndësinë e këtij arkivi Familja Quaroni i ka dhuruar shtetit shqiptar, në formë digjitale, të gjithë arkivën e familjes së saj, me 780 fotografi. Të gjitha fotot e digjitalizuara, mund të shihen sipas një renditjeje kronologjike në formë projekcioni filmik, po në këtë ekspozitë. Është dëshira e familjes Quaroni, që gjithë Arkiva Fotografike Quaroni, Albania 1928 – 1931 të jetë e përdorshme për të gjithë të interesuarit për historinë e Shqipërisë, si nga historianët, studiuesit, diplomatët, gazetarët, ashtu dhe studentët shqiptarë e të huaj.

Vizitorit i jepet mundësia të zbulojë ngjarjet, personat, jetën e përditshme, peizazhet dhe traditat shqiptare, të para e të jetuara nga çifti Quaroni në një kontekst historik dhe social, i cili paraqet shumë interes: pamje befasuese dhe autentike, një vështrim i mirëfilltë dhe jo fort i zakonitë, në mënyrë



të veçantë mbi figurat politike dhe personazhet që kanë dominuar skenën shqiptare përgjatë viteve '20 dhe '30. Arkivi është ruajtur në Itali nga familja Quaroni dhe është sjellë në Shqipëri nga mbesa e Pietro dhe Larissa Quaroni-t, Cristina Quaroni, e cila, nëntëdhjetë vjet pas gjyshërve të saj, vjen në Shqipëri si bashkëshortja e Ambasadorit të Spanjës. Ekspozita është, pa dyshim, një mënyrë për të nderuar kujtimin e gjyshërve të saj, por në mënyrë të veçantë ka për qëllim të vërë në dispozicion të studiuesve shqiptarë dhe italianë një pasuri me vlerë historike.



Me rastin e 160-vjetorit të botimit të versionit të parë të "Rubajive" (Rubaiyat) të Omar Khayyami-t, të përkthyer nga Edward Fitzgerald-i

ENIGMA E EDWARD FITZGERALD-IT

Nga Jorge Luis BORGES

Një njeri, Omar ben Ibrahim-i, lindi në Persi në shekullin XI të erës kristiane, domethënë, për të, në shekullin V të hixhrit. Ai mësoi Kuranin dhe traditat bashkë me Hassan ben Sabbah-un, themelues i sektit të ardhshëm të Haschischin-ëve ose të Assassin-ëve, dhe me Nizam el-Mulk-un që do të bëhej vezir i Alp Arslan-it, i sundimtarit që pushtoi Kaukazin. Të tre miqtë, gjysmë me shaka, gjysmë përnjëmend, u betuan që, në qoftë se ndonjë ditë fati do t'i ecte mbarë njërit prej tyre, miku fatlum nuk do t'i harronte dy të tjerët. Me kalimin e viteve, Nizam-i arriti të bëhej vezir. Omar-i i kërkoi vetëm një qoshe në hijen e fatit të tij të lumtur, ku mund të lutej për mbarësinë e mikut të tij dhe të merrej me matematikën. (Hassan-i i kërkoi një post të lartë, të cilin e mori. Më në fund, ai arriti ta vriste me kamë vezirin.) Nga thesari i Nishapurit, Omar-i mori një pension vjetor prej dhjetë mijë dinarësh dhe pati mundësi t'ia kushtonte kohën studimit. Ai nuk besonte tek astrologjia që lidhej me drejtësinë, por merrej me astronominë, bashkëpunoi për reformën e kalendarit që kishte ndërmarrë sulltani dhe hartoi një traktat për algjebërën që u jepte zgjidhje numerike ekuacioneve të shkallës së parë e të shkallës së dytë dhe në saje të interseksionit të prerjeve konike, u jepte zgjidhje gjeometrike ekuacioneve të shkallës së tretë. Ai vëzhgonte pa u lodhur të fshehtat e numrave dhe të yjeve. Në vetminë e bibliotekës së tij, lexoi tekstet e Plotin-it, i cili në fjalorin e Islamit ishte Platoni egjiptian ose Mjeshtri grek, dhe pesëdhjetë e ca letrat e enciklopedisë heretike dhe mistike të vëllezërve të Dëlirësisë, ku shpjegohej se gjithësia (universi) ishte një shprehje (émanation) e Unitetit të paracaktuar për t'u kthyer tek Uniteti... Thonë se ai qe nxënës i Alfarabi-t i cili mendonte se trajtat universale nuk ekzistonin jashtë gjërave dhe nxënës i Avicenës i cili thoshte se bota ishte e përvetshme. Një kronikë tregon se ai besonte ose zbavitej duke besuar te shtegtimi (transmigration) i shpirtit nga një trup njeriu në një trup kafshe. Njëherë, ai foli me një gomar, siç foli Pitagora me një qen. Ai ishte ateist, por dinte t'u bënte një interpretim besnik (orthodoxe) pasazheve më të vështira të Kuranit, sepse çdo njeri i mësuar është teolog dhe se, për të qenë i tillë, besimi nuk është i domosdoshëm. Në intervalet midis studimit të astronomisë, të algjebërës dhe të apologjetikës, Omar ben Ibrahim al-Khayyami hartoi katërvargëshat, në të cilët vargu i parë, i dytë dhe i fundit rimonin së bashku. Dorëshkrimi më i plotë përmbante pesëqind nga këta

katërvargëshat, një numër fare i vogël që do të ndikonte për keq në lavdinë e tij, sepse në Persi, ashtu siç ndodhte në Spanjën e Lope de Vega-s e të Calderon de la Barca-s, poeti duhej të ishte shumë prodhimtar.

Në vitin 517 të hixhrit, Omar-i ishte duke lexuar një traktat të titulluar *Një dhe disa*. Leximin e tij e ndërpreu një gjendje të fikëti ose një parandjenjë. Ai u ngrit, vuri një shenjë te faqja që sytë e tij nuk do ta shihnin sërish dhe u pajtua me Zotin, me atë Zot që ndoshta ekzistonte dhe hirin e të cilit e kishte kërkuar në faqet e vështira të algjebërës së tij. Ai vdiq po atë ditë, në të perënduar të diellit.


Në këtë kohë, në një ishull të Perëndimit, të cilin nuk e njihnin hartografët e Islamit, një mbret sakson që kishte mposhtur një mbret të Norvegjisë, u mund nga një dukë norman.

Rrodhën shtatë shekuj, plot drita, agoni dhe ndryshime të theksuara (mutations). Në Angli lindi një njeri, Fitzgerald-i, që nuk ishte aq intelektual sa Omar-i, por ndoshta ishte më i ndjeshëm dhe më i trishtuar. Fitzgerald-i e dinte se letërsia ishte fati (destini) i tij i vërtetë dhe ai u mor me të me plogështi e me durim. Ai e lexoi dhe e rilexoi "Don Kishotin" që iu duk pothuajse më i miri nga të gjithë librat (por nuk mundi të tregojë i padrejtë



ndaj Shakespeare-it dhe ndaj dear old Virgil.) Dashuria e tij shtrihej te diksioneri ku ai kërkoi fjalët. Ai e dinte mirë se çdo njeri, shpirti i të cili përmbante njëfarë muzike, mund të hartonte vargje dhjetë ose dymbëdhjetë herë gjatë jetës së vet, në qoftë se yjet ishin dashamirës ndaj tij, por ai nuk kishte ndër mend ta shpërdoronte këtë privilegj të vogël. Ai kishte miqësi me personazhe të ndritura, si Tennyson-i, Carlyle-i, Dickens-i e Thakery. Megjithëse ishte modest dhe i mirësjellshëm, nuk e ndiente veten inferior para tyre. Ai kishte botuar një dialog të shkruar siç e kërkonin të gjitha rregullat, "Euphranor-in", ca përkthime mediokre nga Calderon de la Barca dhe nga tragjedianët grekë. Nga studimi i spanjishtes, ai kaloi në studimin e persishtes dhe filloi të përkthente "Mantiq-al-Tayr", një epopë mistike në të cilën zogjtë kërkojnë mbretin e tyre, Simurgu-n, dhe më së fundi mbërrijnë në pallatin e tij, përtej shtatë deteve, për të zbuluar se ata vetë ishin Simurg-u dhe se Simurg-u ishte njëherazi ata të gjithë dhe secili prej tyre. Aty nga viti 1854 dikush i huajti një përmbledhje të shkruar me dorë të katërvargëshave të Omar-it, të sistemuara vetëm sipas rendit alfabetik të rimave. Fitzgerald-i i përktheu disa prej tyre në latinisht dhe i shkoi ndër mend se me ta mund të bënte thurimën e një libri të pandërprerë, organik, fillimi i të cilit do të përmbante imazhet e mëngjesit, të trëndafilut dhe të bilbilit, kurse fundi do të përmbante imazhet e natës e të varrit. Këtij projekti të papërfytyrueshëm që kishte pak gjasa të sendërtohej, Fitzgerald-i do t'i kushtonte jetën e tij prej njeriu të plogësht, vetmitar dhe maniak.

Më 1859 ai botoi versionin e parë të "Rubajive" (Rubaiyat), i cili u pasua nga versione të tjera, të pasura me variacione dhe me shqetësimet për t'i përkthyer më mirë. Ndodhi një mrekulli: nga bashkimi i rastësishëm i një astronomi persian që begenishte të merrej me poezi dhe i një anglezi tuhaf që lexonte shpejt e shpejt libra orientale e hispanikë, ndoshta pa i kuptuar plotësisht, lindi një poet i jashtëzakonshëm i cili nuk i përngjante as njërit as tjetrit. Swinburne-i shkroi se Fitzgerald-i "i ka bërë Omar




Khayyami-t një vend të përjetshëm midis poetëve më të mëdhenj të Anglisë”, kurse Chersterton-i, i ndjeshëm ndaj elementeve romantike dhe klasike që përmbante ai libër i pashoq, na shtyn të vinim re se në të kishte njëherazi “një melodi që zhdukej në ajër dhe një mbishkrim që mbetej”. Disa kritike ishin të mendimit se “Omar-i” i Fitzgerald-it, në të vërtetë, ishte një poemë angleze e zbukuruar me aludime persiane. Fitzgerald-i ka ndërkallur, ka përsosur dhe ka sajuar, por “Rubajitë”(Rubaiyat) e tij duket sikur kërkojnë që ne t'i lexojmë si rubaji persiane dhe të lashta.

Një rast i tillë na shtyn të bëjmë hamendësime të rendit metafizik. Siç e dimë, Omar-i shpalli doktrinën e Platonit dhe të Pitagorës për kalimin e shpirtit nëpër trupa të shumtë. Në mbarim të shekujve, ka mundësi që shpirti i tij të jetë rimishëruar në Angli, për të përmbushur, në një idiomë të largët gjermanike të ndikuar nga latinishtja, fatin letrar që matematika e kishte penguar ta përmbushte në Nishapur. Isaac Luria le Lion-i ka qenë i mendimit se shpirti i një të vdekuri mund të depërtojë te një shpirt i pafat për ta përkrahur ose për ta mësuar. Ndoshta aty nga viti 1857 shpirti i Omar-it hyri brenda në shpirtin e Fitzgerald-it. Te “Rubajitë” (Rubaiyat) lexojmë se historia e universit është një shfaqje që Zoti e koncepton, e paraqet dhe e sodit. Ky spekulim (spéculation), emri teknik i të cilit është panteizëm, do të na shtyn të mendonim se anglezi mund ta rikrijonte poetin persian, sepse që të dy në thelb ishin Zoti ose fytyra të çastit të Zotit. Ka më shumë gjasa dhe është po aq e mrekullueshme që në vend të hamendësimeve të mbinatyrshme të pranojmë veprimin e një rasti mirëdashës. Nganjëherë retë marrin trajtën e maleve ose të luanëve. Në një mënyrë analoge, trishtimi i Edward Fitzgerald-it dhe një dorëshkrim prej letre të zverdhur, i mbuluar me shkronja ngjyrall, i harruar në një raft të Bibliotekës Bodleiane të Oxford-it, për fatbardhësinë tonë, kanë marrë trajtën e poemës.

Çdo bashkëpunim është një mister. Bashkëpunimi midis anglezit e persianit ka qenë një mister më i madh sesa asnjë tjetër, sepse ata ishin shumë të ndryshëm nga shoqi-shoqi. Ndoshta në jetë, ata nuk do të kishin zënë miqësi dhe se vetëm vdekja, tallanditë dhe koha bënë të mundur që njëri ta njohë tjetrin dhe që ata të dy të ishin një poet i vetëm.

Përktheu: Anton PAPLEKA



1

Natën kur flinja, më tha shpirti: “Pi!
Në gjumë dhe në Varr s’ka lumëri;
Ngrëh-u! Sa rron, zbras Kupa dhe puth Çupa;
Ke shekuj që të flesh në qetësi.”

2

Në ëndërr, kur Agimi zbardhëllonte,
Një zë që nga Taverna po gjëmonte:
“Çohuni, djem, e Verë sillnani,
Se Fati na e thau lëngun sonte.”

3

Dhe posa në Tavernën këndoj gjeli,
Besnikët jashtë thirrë: “Portat çel-i!
E shkurtër është Jeta, ja, u-mplakmë
Dhe mbetmë si kofini pas të vjeli.”

4

A di përse këndesi po këndon
Me-natë dhe nga gjumi po të zgjon?
Që shkoj një ditë po të lajmëron,
Dhe ti, çkujdesur, fle dhe ëndërron.

5

U-gdhi! Me Verë zëmren zbardhëllonj,
Për-dhe çdo Fe të Natës e dërrmonj:
Në Djallë dërgonj Parajsën e përpjetë,
Gërshetin me Llaut’ e lavdëronj.

6

Kur Diellin, me zjarr kurorëzuar,
E pret me gas Natyra fage-shkruar
Shoqen me mall po shoh në gjumë shtruar
Dhe foshnjën buzë-qeshur më të zgjuar.

7

Ja, Kup’ e Qjellit skuqet prej Agimit,
Bilbili nisi këngën e dëfrimit
Me Trëndafilin: Eja, Fage-pjeshkë,
Natyra qesh; nem Qelqin e Rubinit.

8

Zgjob-u! Mëngjezi me shigjet’ e grisi
Perden e Natës, Yjt’ i arratisi,
Dhe Dielli gjahtar me reze kapi
Çdo majë mali e pallati e lisi.

9

O Ëngjell fage-dritë, ja u-gdhi,
Shtir Verë dhe këndo me ëmbëlsi
Xhamshidi e Khosroj qysh lulëzuan,
Qysh dimërojnë sot në Varr-verri.

Përkthyer nga Fan Noli



Ismail Kadare së bashku me bashkëshorten, Helenën,
një takim i ngrohtë me fëmijët në Driën Ndërkombëtare të Jetimëve